Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 11 (31). NENTOR 2008. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

"Risku" sh.p.k.
Market "Ken"
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

"Aurora Group" vlerësohet me "Trofeun e Artë Ndërkombëtar të Cilësisë"

Presidenti i Kompanisë, dibrani Rakip Suli, merr çmimin në një ceremoni madhështore në Londër

KRITERET MBI TE CILAT U DHA ÇMIMI:

- Lidershipi
- Qëndrueshmëria dhe rritja e tregut
- Inovacioni dhe teknologjia
- Shërbimi ndaj klientit
- Angazhimi për kualitet dhe përmbushje standardesh
- Satisfaksioni i punonjësve
- Shërbimi dhe satisfaksioni i klienteve

LEXONI NË FAQEN 9



Në foto: Presidenti i Aurora Group, z. Rakip Suli duke marrë çmimin nga Presidenti i B.I.D, Jose Pietro. *Londër, 24 nëntor 2008*

Skënderbeu në Peshkopi

Një përmendore madhështore për Skënderbeun po punohet nga skulptori Sadik Spahia, Dekan i Fakultetit të Arteve Figurative. Shtatorja është sponsorizuar nga biznesmeni dibran Zaim Korsi. Shtatorja 3.3 metra e lartë, do vendoset mbi një piedestal 1.5 metra para Pallatit të Kulturës në Peshkopi në pranverë.

Faqe 4-5



Në foto: Para shtatores së Skënderbeut që po punohet. Nga e majta në të djathtë: Zaim Krosi, Qerim Sula, Naim Plaku dhe Sadik Spahia.

DEBAT

PO MBYTET DIBRA, KU JANË DIBRANËT?

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 6-7

AKTUALITET

Ja si po ecin punimet në Rrugën e Arbërit

Nga: **ING. SHKËLQIM LUSHA** - FAQE 2

AKTUALITET

Dibra e Madhe po plaket

Nga: **REXHEP TORTE** - FAQE 10

BOTIME

Poetika e legjendës

Rreth librit ***Legjenda e një fisi*** të Ilir Spatës

Nga: **XHAFER MARTINI** - FAQE 12-13

"Transform", libri që mban erë Shqipëri

Nga: **BEQIR SINA** - FAQE 15

Po mbushet gati një vit nga dita kur filluan për herë të parë punimet në segmentin e parë të rrugës së Arbërit, Bulqizë-Ura e Çerenecit. Po të punohet me këto ritme dhe në segmentet e tjerë të Rrugës së Arbërit jemi të bindur se Dibra shumë shpejt do të bashkohet me Tiranën

Posta e Rruga Arbërit


Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Agron Tufa, Viron Kona, Sakip Cami, Perikli Jorgoni, Selman Mziu, Ymer Keta, Xhelal Roçi, Ali Hoxha, Kujtim Boriçi, Beqir Sina, etj., se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Redaksia:
Në Dibër:
Rexhep Torte
Në Athinë:
Abdurrahim Ashiku
Në Itali:
Selman Mziu
Në New York:
Beqir Sina
Në Tiranë:
Prof. Dr. Bashkim Lleshi,
Naim Plaku

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. (04) 2233 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Ja si po ecin punimet në Rrugën e Arbërit

Shumë shpejt do të fillojë tenderimi i segmentit të dytë, Bulqizë - Tiranë

Nga: **Ing. SHKËLQIM LUSHA**



Asfalt mbi Rrugen e Arberit . Foto: Grehans Uka

Po mbushet gati një vit nga dita kur filluan për herë të parë punimet në segmentin e parë të rrugës së Arbërit, Bulqizë-Ura e Çerenecit. E sot po të flasim me gjuhën e shifrave dhe volumeve e punës së kryer themi me bindje se vërtet është punuar me ritme të larta. Po të punohet me këto ritme dhe në segmentet e tjerë të Rrugës së Arbërit jemi të bindur se Dibra shumë shpejt do të bashkohet me Tiranën në një distancë prej 74 km.

Në këtë segment rruge kanë punuar firmat e njohura si "Albavia" e "Karl Gega" Shkodër, "Euraldi SHPK" Peshkopi dhe "Delia Group" Pukë, "Almo Konstruksion" Dibër, "Ulza ndërtim" Mat si dhe "GPG" e "Euro star". Sot pothuaj në të gjithë këtë segment rruge gërmimet janë drejt përfundimit. Me ritme të larta është ecur dhe në veprat e artit të cilat kanë qenë jo të pakta. Në tre lotet e këtij segmenti kanë filluar dhe shtresat asfaltike. Kështu në lotin e parë ku punojnë "Albavia" e "Karl Gega" realizimi i vlerës është në masën 63%. Janë gërmuar dhe zhvendosur 85000 m3 dhe. Janë përfunduar veprat e artit në masën 95%. Është kryer nënshtrsa rrugore në masën 68% ose 25000m3. Shtresa asfaltike në masën 20%. Në lot 2 ku punon "Euraldi SHPK" dhe "Delia Group" janë realizuar këto volume pune: Realizimi i vlerës totalë në masën 65%. Është gërmuar dhe zhvendosur 178000 m3 dhe e shkëmb e gjitha kjo në masën 95%. Nënshtresa rrugore 25000 m3 ose 69%. Shtresa asfaltike në masën 25%. Në lot 3 punojnë "Almo konstruksion", "Ulza ndërtim", "GPG" si dhe "Euro star". Ky është një nga pjesët më të vështira të këtij segmenti. Në këtë lot është realizuar vlera totale në masën 65%. Janë gërmuar dhe zhvendosur dhe e shkëmb 251700 m3 ose 90% e gjithë gërmimeve sipas projektit. Janë realizuar 90% e veprave të artit. Shtresa rrugore 16000 m3 ose 48% e të gjitha shtresave. Shtresa e asfaltit është realizuar në masën 17%.

> Pra, i gjithë volumi i punës së kryer në të tre lotet e këtij segmenti arrin 65%. Gërmimet pothuaj kanë mbaruar të gjitha përveç pak gjërave të vogla që kanë mbetur.
> Po punohet me ritme të shpejta në shtresat rrugore si dhe në shtresat asfalitike

Pra, i gjithë volumi i punës së kryer në të tre lotet e këtij segmenti arrin 65%. Gërmimet pothuaj kanë mbaruar të gjitha përveç pak gjërave të vogla që kanë mbetur. Po punohet me ritme të shpejta në shtresat rrugore si dhe në shtresat asfalitike megjithëse koha tashmë nuk është e përshtatshme për një proces pune të tillë. Edhe veprat e artit si kanale, tombino dhe një pjesë muresh kanë mbaruar. Mbeten për të përfunduar urat si dhe disa pjesë muri.

"Nuk është mbushur ende një vit nga koha që u hodhën kazmat e para në këtë segment, shprehet inxhinier Shaban Bitri, administrator i kompanisë "Almo konstruksion", dhe po të llogariten vështirësitë e mëdha që kemi hasur, jemi të bindur se në të tre lotet është punuar shumë e me cilësi të lartë. Kjo është vërtet një rrugë e kategorisë së parë dhe për të ardhur deri këtu ku jemi, na është dashur mjaft punë, është derdhur mjaft djersë. Skarpatat shkojnë mbi 30-40 metra. Sigurimi teknik i punonjësve ka qenë primare. Sigurimi i rrugës pasi trafiku i ngjeshur shpesh na pengonte. Për këtë tregojnë dhe volumet e punës që janë kryer dhe shifrat janë ato që flasin vetë". Tashmë këtij segmenti po i vjen fundi. Që Dibra të bashkohet me Tiranën duhet që të fillojnë punimet në segmentet e tjrë të kësaj rruge. E jemi të bindur se shumë shpejt do të tenderohet pjesa nga Klosi (Ura e Vashës) e deri në Bulqizë. Atëherë dibranët do të binden se nuk do të jetë e largët ajo ditë që atë rrugë ku të parët tanë e kanë shkelur më këmbë, tashmë ne do e shkelim me makinë.

Bulqiza vajton përsëri



Vdiq edhe një minator tjetër në minierën e Bulqizës. Vetëm pak minuta para se të përfundonte orarin e punës minatori Ivzi Veseli humbi jetën poshtë zgafellave të frikshme të nëntokës. E prisnin dy fëmijët e tij, gruaja dhe të gjithë të afërmit por 47 vjeçari Ivzi Veseli, këtë mëngjez të ftohtë nëntori u kthye i vdekur në shtëpinë e tij mbi supet e shokëve Punonte në nivelin 16 duke hapur vrimat e minave por gjeti vdekjen nga shpërthimi i fortë i eksplozivit. Fakt është tashmë se Ivzi Veseli nga fshati Herbel humbi jetën poshtë në pusin nr2,në thellsitë 800 metra. Tragjedia në familjen Veseli është e madhe pasi para viteve nëntëdhjet po në minierën e Bulqizës të njëjtin fat pati dhe vëllai i Ivziut i cili humbi nëpër zgafellat e lagështa të kësaj miniere pa iu gjetur as eshtrat. Në ceremoninë mortore morën pjesë shokë e miq të familjes Veseli por shteti heshti dhe Ivziu e mori përgjegjësinë e vdekjes së vet me vete në varr. Dhimbje, lot e zi kanë përjetuar familjarët, miq e të afërm të viktimës gjatë ceremonisë mortore. Gjatë kohës që trupi i pa jetë i Ivzi Veselit përcillej për në banesën e fundit, një përfaqësi e minatorëve të Bulqizës zhvilluan një protestë duke i bërë thirrje shtetit që të shqetësohet seriozisht për Bulqizën, dikur qytet të njohur ku minerali i kromit çante bllokadën e sot është kthyer në një qytet të mjerimit shqiptar. Shteti dhe vetëm shteti është përgjegjës direkt për këtë varfëri të tej skajshme në Bulqizë, thanë protestuesit atë ditë para kryeministrisë. Apeli që bëjnë minatorët është që ndërhyrja direkte e qeverisë, ndalon dhe këto tragjedi të një pas njëshme që po ndodhin. Në këtë ceremoni mortore morën pjesë edhe përfaqësues të firmës ruso-austriake, të cilët konfirmuan lidhjen e një pensioni për familjen e minatorit të vrarë. Nuk janë pak por vetëm në dy vjet e gjysmë në galeritë e thella të nëntokës kanë humbur jetën 18 minatorë. Nuk është vetëm nëntoka e Bulqizës që po rrëmben jetë njerëzish të pafajshëm. Këtu shikon dhjetra e dhjetra fëmijë të vegjël të cilët kanë braktisur bankat e shkollës, kanë flakur librat dhe në çantat e tyre futin çdo ditë gur të vegjël kromi të cilët i shesin tek "pronarët" e këtyre stoqeve të mbetura . Mes tyre stoqeve kanë mbetur dhe viktima dhe shteti ka bërë rolin e të paditurit. Vetëm pak dit më parë në këto stoqe kromi një banorë u plagos një një shpërthim eksplozivi. Askush nuk mbajti përgjegjësi as për këtë plagosje. Bulqizakët më tepër po i vret heshtja e shtetit. E deri sa shteti do të hesht Bulqiza do të vazhdojë të vajtojë e lotët e nënave nuk është lehtë të thahen nga sytë e tyre.

Sh.Skarra

Prefekti i Dibrës, z. **Xhafer Seiti** i shkruan Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, z. Ylli Pango: Kërkohet një grup specialistësh të Ministrisë për të vënë piketat në vendet më pikante për turizmin.

Objektet turistike në Dibër kërkojnë vëmendjen e shtetit





Nga XHAFER SEITI*

Në qarkun e Dibrës për të gjitha vitet e demokracisë nuk është vënë dorë për problemet e turizmit, nuk ka pasur asnjë lloj investimi, gjithçka i është lënë spontanitetit

Problemet e turizmit në qarkun e Dibrës janë ndjekur në vijimësi nga Institucioni i Prefektit, pavarësisht faktit që në këtë qark nuk ka Zyrë Rajonale të Turizmit, gjë që e kemi konsideruar domosdoshmëri, në njësitë vendore nuk ka një strukturë apo person të caktuar për të ndjekur këtë problem dhe Institucioni i Prefektit ka një organikë të cunguar dhe problematika, që ndjek, është tepër e ngjeshur.

Gjithsesi problemet e turizmit, krahas me ato të kulturës, rinisë e sporteve në çdo moment kanë pasur vëmendjen e duhur nga institucioni ynë duke synuar të japim ndihmë modeste e të bëhemi pjesë e zgjidhjes së problemeve.

Me kërkesë të institucionit, që ju drejtoni, herë pas here kemi sjellë të dhënat e kërkuara, kemi plotësuar formularë për hotele e mjedise të mundshme për turizëm, kemi parashtruar para jush vendet me resurse të jashtëzakonshme për turizmin, kemi bërë dhe propozime konkrete, por për të gjitha shkresat tona (ndër ta përmendim atë nr. 1027 prot, datë 25.05.2006, nr. 1259/1 dhe 1333/1 të qershorit 2007, 1448/1 datë 02.07.2007, 1516/1 datë 06.09.08 etj), kurrë nuk morëm përgjigje.

Që nga viti 2006 kemi bërë një sërë komunikimesh shkresore, si me Ministrinë tuaj, ashtu dhe me institucionet qendrore në nivel vendor dhe organet e qeverisjes në njësitë vendore të qarkut Dibër, ku kemi ngritur problemet për turizmit në këndvështrimin tonë dhe kemi kërkuar angazhim maksimal të gjithë aktorëve e faktorëve për ecuri më të mirë në fushën e turizmit. Njëkohësisht subjektet e faktorët e rëndësishëm në fushën e turizmit dhe Organet e Qeverisjes Vendore i kemi pajisur me bazën e plotë ligjore në këtë fushë.

Me shkresën nr. 1027 prot, datë 25.05.2006 "Për nevojën e ndërhyrjes me investime në Parkun Kombëtar të Lurës në veçanti dhe për zhvillimin e turizmit në qarkun e Dibrës", drejtuar ish-ministrit, zotit Bujar Leskaj dhe për dijeni Kryeministrit të Shqipërisë, zotit Sali Berisha, Ministrit të Brendshëm, zotit Sokol Olldashi dhe dhjetë deputetëve që në një mënyrë apo tjetër kanë lidhje me qarkun e Dibrës, kemi kërkuar e argumentuar domosdoshmërinë e ndërhyrjes së shtetit me investime për turizmin në këtë qark me resurse të shumta, duke filluar nga Parku Kombëtar i Lurës, i cili në fakt vetëm emrin ka të tillë, për të vazhduar me shumë e shumë mjedise që me të vërtetë mund të konsiderohen "pasuri të çuara dëm".

Jo vetëm nga unë si Prefekt, por dhe nga një opinion i tërë intelektual në qarkun e Dibrës është vlerësuar përkushtimi i Kryeministrit të Shqipërisë, zotit Sali Berisha për këtë problem dhe porositë e dhëna prej tij për institucionet përgjegjëse.

Duke përsëritur ato që kemi vënë në dijeninë tuaj dhe herë të tjera sipas kërkesës informojmë:

Qarku i Dibrës dallohet për një numër të madh objektesh me vlera të spikatura historike, kulturore e natyre, të cilat tërheqin vëmendjen e studiuesve dhe vizitorëve.

Nxjerrja në pah e këtyre vlerave, përbën një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në këtë rajon.

Në shkallë qarku janë gjithsej 65 objekte të propozuara për monumente natyre, nga të cilat 12 si monumente natyre të rëndësisë kombëtare si: Liqenet e Kacnisë, (në shpatin e malit të Balgjajt), Liqeni i Zi (në malin e Korabit), Ujëvata e Pocestës (në shpatin lindor të malit të Deshatit), Lisi i Madh (në Parkun Kombëtar të Lurës), Shpella e Qytezës (në afërsi të fshatit Bellovë), burimi termomineral i Ilixhave të Peshkopisë, liqeni i Luleve, liqeni i madh, liqeni i zi (tre liqene në parkun kombëtar të Lurës), Boroviku i Begjunecit (në afërsi të fshatit Rabdisht), Fusha e Pelave (në parkun Kombëtar të Lurës), liqeni i zi i Martaneshit.

Një pjesë e mirë e këtyre monumenteve ndodhen në Parkun Kombëtar të Lurës. Ky par, me lartësi 1375-1919 metra mbi nivelin e detit, ndodhet 55 km larg qytetit të Peshkopisë, ka një sipërfaqe 1180 ha, nga të cilat 1100 ha pyje, 80 ha kullota së bashku me sipërfaqen ujërave të liqeneve, konsiderohet si një nga perlat e natyrës shqiptare, por ka një infrastrukturë rrugore që në dekada është lënë pas dore.

Parku ka 14 liqene akullnajorë, nga të cilët shtatë mbajnë ujë gjatë gjithë vitit. Në pjesën jugore të parkut ndodhet livadhi Fusha e Pelave me sipërfaqe 18 ha, një mrekulli e natyrës.

Do të quanim me vend ripropozimin për një përpjekje të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për ta futur Parkun Kombëtar të Lurës në planet e mbrojtjes së UNESKO-s.

Në qarkun e Dibrës janë të shumta mjediset me vlera të spikatura peizazhore, estetike, çlodhëse dhe kurative si në Qafë Shtamë dhe liqenet e Gërmanjit në Mat me shtrirje deri në Krujë, në Ulëz, Derjan e në shumicën e komunave të Matit, në disa pika të Martaneshit, Zerqanit, Shupenzës, Gollobordës, Ilixhat e qytetit Peshkopi, në gjatësinë e lumit Drin nga Gjorica në Qafë të Kolesjanit, të lumit të Matit e zalleve aq piktoreskë, të liqeneve të shumtë, në mjediset e mrekullueshme të Kalasë së Dodës, Sllovës, Selishtës, Luznisë, Arrasit, Zall Dardhës, Zall Reçit etj.

Nga gjithë kjo mori resursesh mund të përzgjidhen mjaft vende turistike ku mund të vihet dorë nga shteti për të krijuar mjedise të kulturuara për një turizëm të kulturuar.

Në qarkun e Dibrës, në çdo cep të tij, syri i specialistit shikon një vend ku me pak shpenzime mund të kthehet në qendër turistike dimërore apo verore për turistët të huaj, por dhe për shtetas shqiptarë brenda e jashtë qarkut.

Edhe për vitin 2008, siç kemi informuar dhe më parë, u vu re prirja që njerëzit duan të dalin nga shtëpitë, të kalojnë një fundjavë larg saj, por atje ku grupohen apo grumbullohen nuk ka asnjë lloj kushti. Kështu ndodh me përpjekjet për të bërë plazh pranë lumenjve Drin e Mat, pranë zalleve, apo liqeneve, duke u ngritur tashmë mbi paragjykimet, apo për të kaluar ditë festash në vende e pika të ndryshme realisht pushim pranë staneve në bjeshkë, por pa asnjë kusht të plotësuar, ose me kushte modeste të krijuara nga ndonjë privat siç ka ndodhur në bjeshkët e Hinoskës në komunën Melan që për vitin 2008 qenë shumë të frekuentuara.

Më lejoni të nënvizoj se në qarkun e Dibrës për të gjitha vitet e demokracisë nuk është vënë dorë për problemet e turizmit, nuk ka pasur asnjë lloj investimi, gjithçka i është lënë spontanitetit, duke shpresuar se nën drejtimin tuaj do të ketë rikonsiderim të këtyre problemeve.

Me vlerë do të konsideronim organizimin e një studimi me grup specialistësh të ministrisë suaj për të vënë piketat në vendet më pikante për turizmin.

Duke ju falënderuar sinqerisht për mirëkuptimin, shprehim gatishmërinë për të ndihmuar me sa të mundemi në plotësim të kërkesave tuaja.

** Autori është Prefekt i Dibrës. Titulli është i redaksisë.*

Drejtori i Qendrës Nacionale për konservimin e trashëgimisë kulturore të Maqedonisë viziton Dibrën e Madhe

Behixhudin Shehapi: Do rikonstruktohet Hamami i Vjetër

Në Dibër të Madhe qëndroi për vizitë Behixhudin Shehapi, drejtor i Qendrës nacionale për konservimin e trashëgimisë kulturore të Maqedonisë me bashkëpunëtorët e tij. Qëllimi i kësaj vizite ishte konservimi dhe rikonstruimi i Hamamit të Vjetër në Qytet, që ndodhet në veriperëndim të Xhamisë së Hynqarit.

Argëtim Fida, deklaroi para medieve se, "kjo Qendër nacionale, ka angazhuar ekspertët e saj për të bërë projektin për mbrojtjen dhe rikonstruimin e këtij objekti të rëndësishëm dhe nga më të vjetrit në qytetin tonë".

Behixhudin Shehapi,shtoi se: "Në vazhdimësi Dibra e Madhe si qytet i vjetër dhe me shumë objekte të trashëgimisë kulturore mbetet në fokusin e Qendrës nacionale për konservim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Në kuadër të programit për veprim në vitin 2008 kemi parashikuar të përgatitet elaborate për këtë hamam. Ky hamam i vjetër i arkitekturës profane qytetare i përket shekullit të 16-të. Ekipi i arkitektëve dhe konservatorëve është duke zhvilluar aktivitetet hulumtuese. Pas kësaj do të bëhet përgatitja e projektit për konservim dhe rikonstruksion. Projekti do të përgatitet në kuadër të standardeve të parashikuara në Ligjin për trashëgiminë kulturore. Pas marrjes së lejes nga Drejtoria për mbrojtjen e monumenteve do të merret leja përkatëse. Pastaj në Drejtorinë për mbrojtjen e monumenteve dhe pas financimit nga Ministria dhe donatorë të jashtëm, në fillim të vitit 2009 do të fillojë rikonstruksioni i këtij objekti të rëndësishëm të kulturës qytetare islame në Dibër të Madhe.

Ky është një hamam me karakteristikat e tekhamamave të shekullit të 16-të. Stili i ndërtimit është me gur dhe tulla. Janë ruajtur shtyllat, harqet interesante, përpunimi i stallaktitit dhe çdo gjë do të ruhet ashtu siç është", tha Shehapi

Rexhep TORTE



Në foto: Behixhudin Shehapi dhe Argëtim Fida në mjediset e Hamamit të Vjetër

Botimi i monografisë "Skënderbeu" të Oliver Jens Schmitt, sjellë në shqip nga përkthyesi Ardian Klosi hap një debat mbi figurën e Skënderbeut dhe rolin e tij në historinë e Shqipërisë. Prononcohen për debatin personalitete të kulturës shqiptare, mes të cilëve edhe Ismail Kadare

ISMAIL KADARE:

Debati është krejtësisht i gabuar, turpërues për Shqipërinë, për kombin shqiptar, për dinjitetin e kombit shqiptar



Pas **botimit të monografisë "Skënderbeu" të Oliver Jens Schmitt është hapur një debat pro dhe kundër figurës së Skënderbeut. Si-pas jush, pse tani ky debat dhe çfarë synon?**

Debati është krejtësisht i gabuar, turpërues për Shqipërinë, për kombin shqiptar, për dinjitetin e kombit shqiptar. Do të kujtohet si një gjë e neveritshme më vonë, siç kujtohen barbaritë e Haxhi Qamilit ose të Esat Toptanit. Ky është një debat që përsëritet nëpër shekuj. Problemi është shumë i thjeshtë. Është një mashtrim kolosal në radhë të parë. Skënderbeu është një figurë që nuk ka ç'ti qortohet. Ka figura kundërthënëse në botë siç është Napolon Bonaparti. ka lavdi, ka dhe vërejtje të shumta. Megjithatë e ka zënë vendin e tij në historinë e Francës, në qytetet franceze me bustet e tij. Të kthehemi në Ballkan, i famshmi Drakula i rumunëve. Ka qenë një prijës rumun që ka luftuar në perandorinë osmane, por duke qenë tepër i egër, e liga, mizoritë e tij e errësuan figurën dhe ndërsa rumunët mundohen më kot ta mbrojnë, disa natyrisht e kanë mohuar. Europa e ka hedhur poshtë me përçmim dhe ai është bërë simbol i së keqes. Pra, komuniteti europian ka qenë i pamëshirshëm me figurat që ndonëse kanë kryer një rol heroik nga ana e jashtme, kanë qenë të papranueshëm saqë janë mohuar. Tani çfarë ka bërë ky Skënderbeu të keqe që ne shqiptarët duhet ta vëmë në diskutim? Dhe del një gjerman në mënyrë të papritur që ka nja njëmijë e pesëqind libra për të dhe ne duhet si servil të ulim kokën të gjithë dhe të shohim ç'thotë ky gjerman, kur kemi qindra e qindra libra dhe vlerësim të padiskutueshëm të Skënderbeut. Ka qenë një kohë kur ai ishte më i njohur në Europë se në Shqipëri. Figura e tij është zbërthyer nga të gjitha anët. Çfarë i qortohet Skënderbeut? Është vërtet për të vënë duart në kokë. Si është e mundur që kjo çmenduri të ndodh në Shqipëri. Ose kjo lidhet më një shëmti më të madhe që neve sot nuk e kuptojmë, por që do të dalë më vonë. Është një lloj përpjekje për destabilizim psikotik të brendshëm të vendit. Se çfarë ka ku e gjetën të keqen tek Skënderbeu? Disa e qortojnë se tradhtoi Turqinë. Del shqiptari avokat i perandorisë osmane që vetë Turqia e ka hedhur poshtë. Ç'është kjo Shqipëri e sotme? Disa kërkojnë heqjen e tij historia e Shqipërisë dhe vendosjen e Ballaban Pashës në vend të tij, shikoni pra një kthim kokëposhtë një tallje me kombin shqiptarë.

Disa thonë që emri i babait është Ivan dhe jo Gjon?

Domethënë Skënderbeu ka këto dy alternativa që i lejohen tani nga renegatët tanë ose të Kosovës, se edhe këta nuk janë më pak aktivë në këtë gjë. Dhe është një turp gjithashtu për Kosovën që ka problemin themelor sot që të mbajë pavarësinë, ta ushqejë pavarësinë dhe lirinë e sapofituar dhe për çudi disa prej gjoja intelektualëve të Kosovës i vënë një njollë kësaj aspirate për të cilën u derdh gjak, e vënë në dyshim papritur dhe duan të tregojnë që edhe nëse do ta mbajmë Skënderbeun ose do ta hedhim si figurë negative që paska tradhtuar perandorinë osmane, se njerëzve u vika keq për këtë perandori. Unë nuk e kuptoj pse. Ose nëse do ta mbajmë, do ta mbajmë si serb. Kjo është shpifje monstruoze. Në fillim u gjet që babai i Skënderbeut paska pasur një grua sllave. Kjo mund të jetë e vërtetë. Tërë feudalët, tërë princat e Europës merrnin gra të huaja dhe asnjëherë gruaja e huaj nuk kthente identitetin e vendit. Tani i gjetën edhe babanë, na e paska serb. Ky është kuptimi shëmtuar i kësaj, d.m.th që nëse kjo figurë do të mbahet, do të mbahet si figurë më zanafillë sllave, që nuk është e vërtetë fare, d.m.th që Kosova do të kthehet përsëri në statusin e provincës serbe dhe normalisht kryezotin e saj, heroin e saj do ta ketë serb. Shikoni pra, "harmonia" do të kthehet si më parë, Kosova ka qenë provincë e Serbisë dhe heroin tani ia gjetën e paska pasur serb, dhe është normale statusi i përjetshëm i saj që duhet të kthehet përsëri aty ku ka qenë dhe është turp për Kosovën për intelektualët e saj që nuk gjejnë energji për të vënë në pozitë të vështirë ata që janë bashkuar në këtë shëmti. Në radhë të parë mendoj se përgjegjësia është këtu tek ne.

Pjesë nga intervista e Ismail Kadaresë në emisionin "Studio e hapur" në TV ALSAT



Ne foto: Skulptori Sadik Spahia dhe biznesmeni Zaim Krosi para shtatores së Skënderbeut që po punohet

Në mënyrën më të kamuflluar ka nisur një sulm i pa parë kundër figurës së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Ka ditë që mediat reflektojnë mbi këto sulme por pjesa intelektuale dhe ajo politike heshtin dhe nuk janë bërë të gjallë. Por kur ndërkohë fushata kundër Skenderbeut fillon, në një studio arti në qendër të tiranës po hedh shtat një shtatore për Skenderbeun 3.3 metra e lartë, e cila në pranverë pritet të vendoset ne qytetin e Peshkopisë. Ky hap, tregon më së miri se kur të tjerët kërkojnë të rrënojnë atë që se kanë krijar vetë, janë vetë njerëzit që e duan këtë vend, që kanë menduar ti ngrenë një përmendore Heroit tonë kombëtar.

SULMI

Vetëm pak javë më parë, Këshilli Bashkiak i Qytetit të Burrelit vendosi të hiqte bustin e Skendërbeut nga qendra e qytetit, duke vendosur në të njëjtin vend një bust për Ahmet Zogun. Por, pas reagimit qytetar, drejtuesit e këshillit bashkiak u mbrojtën me argumentin se Burreli meritonte një bust të Skënderbeut të madh, kështu që më mirë ta hiqnin atë të voglin. Por, vetëm disa ditë me parë, përkthyesi Ardian Klosi solli në shqip një monografi të Skenderbeut të Oliver Jens Schmitt. Sipas përkthyesit Klosi në një të përdritshme shqiptare, "kryengritja e Skënderbeut ishte qysh në fillim një akt sa madhështor aq dhe i pashpresë. Sikurse e shtjellon Schmitt-i qartë, gjithmonë në bazë të dokumentacionit dhe fakteve, Skënderbeu asnjëherë nuk ka kërkuar gjysmëzgjidhje, ndonjë principatë autonome vasale etj. Ai që në fillim ka luajtur me të tërën, ka kërkuar dëbimin e osmanëve nga Arbëria dhe Evropa; edhe pse lufta e tij praktikisht ka qenë ajo guerilase, rrallëherë në fushë të hapur, në kombinimet që kërkonte, qoftë me Huniadin ose Korvinin, qoftë me mbretin Alfons, qoftë me Papën Piu II ose me Venedikun, synimi ishte po ai: thyerja e sulltanëve dhe dëbimi i Perandorisë Osmane nga kontinenti. Diku Schmitt-i, lëvizjen e tij e quan tejet konservatore. Skënderbeu së bashku me Aranitin, Muzakën etj., kërkonte rikthimin e gjendjes paraosmane, kur secili fisnik arbër ishte zot i plotë në trevat e sundimit të tij, s'i paguante taksa, nuk i jepte as ushtarë as pengje asnjë lloj perandori. Mospranimi i perandorit të ri në Konstantinopojë - sulltanit - edhe pse sot mund të na duket një gjest i madh, heroik, prokrishterimit etj., ishte vetvetiu një ecje kundër kohës, çka e vërtetoi dhe fundi tragjik i Skënderbeut që la pas vetes një Arbëri të rrënuar, një kasaphanë e një shkretim aq të madh, sa këtij vendi iu harrua edhe emri e vendasit dalëngadalë filluan ta quajnë veten ndryshe, të pajtohen e të bashkëjetojnë me zotërinjtë e rinj në shumë pikëpamje". Sikur të mos mjaftonte me këtë përshkrim të veprës, Klosi e mbyll opinionin e tij kështu: Motivi i parë i braktisjes së kampit osman nga Skënderbeu ka qenë vendeta, gjakmarrja: kërkonte të hakmerrej për babanë e vet, Ivanin, të vrarë nga Murati II.?! Por, pavarësisht nga dokumente të veçanta, libri ... "Skënderbeu" i Oliver Schmitt-it do të ndihmojë që të shpërbëhen në kokat tona mitologjitë skënderbejane, të ndërtuara prej më shumë se njëqind vjetësh".

REAGIMI

Menjëherë pas botimit të librit, kanë reaguar historianë, akademikë, historianë dhe studiues të historisë. Por më i ashpër ka qënë reagimi i shkrimtarit Ismail Kadare, kandidat për çmimin NOBEL, i cili ka thënë: Debati është krejtësisht i gabuar, turpërues për Shqipërinë, për kombin shqiptar, për dinjitetin e kombit shqiptar. Do të kujtohet si një gjë e

historik

Ndërkohë që në Burrel dua ta heqin bustin nga qendra e qytetit dhe Oliver Jens Schmitt e bën gjysëm serb e gjysëm grek, një shtatore 3.3 metra e lartë po përgatitet për tu vendosur në pranverë në Peshkopi

Një përmendore madhështore për Skënderbeun!

Skulptori Sadik Spahia po punon shtatoren e Skenderbeut, e sponsorizuar nga Zaim Korsi. Në Pranverë në Peshkopi, para Pallatit të Kulturës do vendoset shtatorja 3.3 metra e lartë.

neveritshme më vonë, siç kujtohen barbaritë e Haxhi Qamilit ose të Esat Toptanit. Ky është një debat që përsëritet nëpër shekuj. Problemi është shumë i thjeshtë. Është një mashtrim kolosal në radhë të parë. Skënderbeu është një figurë që nuk ka ç'ti qortohet!

Përsa i përket heqjes së bustit në Burrel, u prononcua edhe kryetari i Bashkisë së Burrelit, Skënder Lleshi. Ai e cilësoi vendimin si një vendim kolegjial, duke premtuar njekohësisht edhe gjetjen e menyrave për ndërtimin e një busti më të madh për Burrelin.

Më i ashpër ka qenë reagimi i Komitetit të Organizatës së Veteranëve të LANÇ të rrethit të Matit. Nëj një peticion të drejtuar z. Bujar Nishani, ministër i Punëve të Brendshme, Këshillit të Bashkisë të qytetit Burrel, Prefektit të qarkut Dibër, z. Xhafer Seiti, dhe për dijeni Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bamir Topi, Kryeministërit Sali Berisha, kryetares së Kuvendit znj. Jozefina Topalli, etj, ata shprehen indinjatën e thellë për veprimin e këshillit bashkiak të Burrelit. "Nëpërmjet medias vizive e asaj të shkruar, jemi njohur me tentativën e Këshillit të Bashkisë të qytetit Burrel, për të marrë vendim për heqjen nga sheshi kryesor i këtij qyteti, bustin e bronxtë të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu dhe në vendin e tij të vendoset shtatorja e Ahmet Zogut, ish-mbret i Shqipërisë e i shqiptarëve, thuhet në fillim të peticionit. "Komiteti i Organizatës së veteranëve të LANÇ të rrethit Mat, mbështetur edhe nga mendimet e dhëna në takimet me anëtarësinë e kësaj organizate, si dhe nga opinione të shumta dhënë nga qytetar të ndryshëm deri dhe nga përfaqësues të forcave politike inicuese e këtij vendimi, është tejet i indinjuar, prandaj e injoron këtë nismë për marrjen e këtij vendimi, duke kërkuar njëherazi, urgjentisht heqjen dore nga kjo tentative e rrezikshme".

Më pas, veteranët sjellin disa argumenta për këtë: E para, Simboli historik, busti i Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, pavarësisht se në ç'rrethana është vendosur aty, nuk mund të jetë objekt diskutimi i Këshillit të Bashkisë, përveçse Këshillit të Ministrave. Pra nuk ka një bazë ligjore. E dyta, Është kënaqësi kur njihesh me fakte të shumta, që Gjergj Kastriotin - Skënderbeun e kanë dhe po e respektojnë shumë vende e popuj të Evropës ndërsa neve për interesa politike sektoriale e keqadashëse, po përpiqen ta heqin".

Veteranët e Matit përfundojnë peticionin e tyre, duke premtuar akte të tjera demokratike në mbrojtje të bustit të Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skenderbeu.

Deri më tani, i vetmi reagim zyrtar ka qenë ai i Prefektit të Dibrës, z. Xhafer Seiti. "Prefekti ka të drejtën e verifikimit dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore për vendimet që marrin këshillat vendorë brenda dhjetë ditëve nga data e depozitimit të tyre në institucionin e prefektit", thuhet në përgjigjen e tij. "Siç thoni dhe ju në peticionin tuaj bëhet fjalë për një vendim që akoma nuk është marrë për heqjen e bustit të Skënderbeut dhe vënien e shtatores së Ahmet Zogut, por është i pritshëm dhe, si i tilllë, prefekti nuk mund të shprehet paraprakisht pa pasur më parë në dorë vendimin e argumentuar ligjërisht. Shprehja e prefektit para këtij momenti do ta bënte palë Prefektin dhe Institucionin që drejton, gjë që është në kundërshtim flagrant me ligjin", mbyll përgjigjen e tij zyrtare Prefekti i Dibrës.



Në shtatoren e Spahisë formësohet çdo ditë që kalon një figurë artistike e madhështisë së Skënderbeut, siç nuk është parë kurrë me parë.

SHTATORJA E SKËNDERBEUT

Ndërkohë që media po pasqyron një fushatë "pro" dhe "Kundra" Skënderbeut, në qendër të Tiranës, në studion e skulptorit Sadik Spahia, po punohet një shtatore për Skenderbeun. Kjo shtatore është sponsorizuar nga biznesmeni Zaim Krosi dhe mendohet që stina e pranverës në Peshkopi të vije së bashku me shtatoren. Shtatorja, 3.3 metra e lartë, do vendoset në një bazament rreth 1.5 metra, duke e çuar lartësinë e përmendores 4.8 metra, një ndër më të mëdhatë ngritur për Heroin tonë Kombëtar.

Zaim Krosi, i pyetur për arsyet e këtij sponsorizimi, nuk preferon të flasë shumë, por thekson se "kjo ka qenë një dëshirë e hershme dhe jam shumë i gëzuar që po ia arrij kësaj".

Në studion e Dekanit të Fakultetit të Arteve Figurative në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë, shkojnë pothuajse çdo të shtunë miq dhe dashamirës të tij, por edhe dibranë që kanë informacion se po ndërtohet shtatorja për Skenderbeun. Ata e lënë pa punë "artistin", por edhe ai ndjehet i gëzuar që i ka mes tyre. "Kjo është një vepër që do qëndrojë mes tyre gjatë gjithë kohës, thotë skulptori Spahia, dhe unë, para se kjo vepër të dalë në publik, kam dëshirë të marr çdo perceptim të atyre që neser do ta kenë në qytetin e tyre".

Shtatoren që po punohet e vizitojnë shpesh, përveç sponsorizuesit, Zaim Krosi, edhe Naim Plaku dhe Qerim Sula. I pari ka hartuar tekstin e një kënge për Skënderbeut, ndërsa i dyti e këndon atë. Muzikën e këngës e ka kompozuar kompozitori dibran Përparim Tomcini.

Skënderbeu në shtatoren e artistit Sadik Spahia nuk është siç e kemi njohur ne, në krye të ushtrisë duke luftuar për atdheun, me shpatë në dorë dhe majë kalit, por nuk është as si përshkrimet romaneske të Oliver Jens Schmitt, por është i gjallë, burrëror, mes trimash të tjerë dibranë, që u shtrin dorën dhe i fton për betejat për çlirim. Në shtatoren e Spahisë formësohet çdo ditë që kalon një figurë artistike e madhështisë së Skënderbeut, siç nuk është parë kurrë me parë.

Lidhur me detajet e vendosjes së bustit në qytetin e Peshkopisë, organizatorët kanë menduar çdo gjë, shumicën e të cilëve duan ti ruajnë suprizë për ditën e vendosjes. Gjithçka po ecën normalisht dhe deri në pranverë, kur shtatorja prej bornxi të jetë gati për në Peshkopi, duhet të pritet vetëm një vendim i Këshillit Bashkiak të Qytetit për ta vendosur Heroin Tonë Kombëtar në mes të qytetit të Peshkopisë.

Koresp. "Rruga e Arbërit"

Rruga Arbërit nr. 31

opinion

Debat mbi ndërtimin apo jo të Hidrocentralit të Skavicës. Çfarë duhet të bëjnë dibranët? Gazetari Abdurahim Ashiku me banim në Athinë u bën thirrjeve specialistëve të reagojnë për një vepër kaq të madhe hidroenergjetike në vend.

PO MBYTET DIBRA, KU JANË DIBRANËT?

Letër e hapur drejtuar historianit Ali Hoxha dhe tërë trurit dibran në botë



Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

Të kisha harruar i dashur Ali në fjalën që diçka të shkruaja për brengën tënde dhe timen, brengë që ma do mendja është e të gjithë dibranëve që nuk e kanë përzierë gjakun dhe qelizat e trurit me serbë e mendje serbësh që donin t'i hynin shqipes mes përmes për të dalë e mbushë vegshat me ujë të kripur deti. Arritën që t'i presin kokën e t'i linin trupin, t'ia merrnin qytetin e qendrën gjeografike të shqiptarëve, qendër që ngado që t'i heqësh drejtëzat në Dibër bashkohen.

E fillova këtu bisedën me ty sepse sapo zbrita nga interneti një përkthim të Gëzim Aliut nga gazeta Corriere delle Puglia, Bari XXVI, 354, e 21 dhjetorit 1913 me titull: "**Raport zyrtar paraqitur Fuqive të Mëdha: Ja masakrat serbe të 1913 në Dibër."**

Unë e ti e njohim këtë "raport" falë shkrimtarit të shquar dibran Haki Stërmilli në librin e tij "Dibra në prak të historisë" i vitit 1940 (çuditërisht ende në dorëshkrim) por edhe të "Kalendarit kombjar" dhe "Përlindjes së Shqipërisë" të qeverisë së Vlorës...

E nisa bisedën me "Masakrat serbe në Dibër, sepse ato mu përballen sot kur lexova një njoftim në internet se METE (Ministria e Ekonomisë dhe Tregtisë) kishte shpallë tenderin për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës....

Do të thotë lexuesi në skaj të ngjarjeve se çfarë lidhje kanë masakrat serbe në Dibër, gati një shekull më parë, me hidrocentralin e Skavicës gati një shekull më vonë.

Unë them se ka një lidhje. Masakrat serbe në Dibër kishin si qëllim ta zhduknin popullsinë autoktone, t'i zhduknin shqiptarët dhe në vend të tyre të vendosnin kolonë serbë, plan i cili, afro tri dekada më vonë, do të paraqitej në nivel akademik në leksionin "Shpërngulja e arnautëve" të akademikut famëkeq serb Vasa Çubriloviç. Asaj kohe i takon shpërngulja masive e qytetarëve të Dibrës drejt Tiranës (ku ka edhe sot një lagje me emrin "Lagja Dibrane"), Elbasanit etj.

Ja si e përshkruan shkrimtari Haki Stërmilli pamjen e asaj ikjeje biblike...

"Ndërsa burrat e Dibrës po luftofshin egërshëm mbi majat e Kërçinit, të Korabit dhe të Jabllanicës, familjet e Dibranëve – të qytetit dhe të katundeve – ishin vu n'ikje drejt Tiranës e Elbasanit.

Ishte natë dhe nji nga ata ma të zezat për Dibranin, pse po i thoshte lamtumir Atdheut, liris, pasunis, e lumnis. Ma shumë se 100.000 frymë – gra, burra e çilimij – po vrapojshin drejt Perëndimit për me mos ra në dorë t'anmikut. Terri i natës ishte shdukë nga drita e zjarrit të katundeve të djegun prej Serbëve. Klithma e fëmijëve dhe gjama e grave që përbëfshin koncertin e asaj nate dy herë të zezë, përziheshin me krismën e pushkëve dhe bubullimën e topave për t'u ngjitë naltë. Ky ishte marrshi funeral i Dibrës së vorrueme në robëni, ishte vaji i zemrave të plasuna e të përvëlueme për liri. Dy kortezhë të gjatë – Dibër – Elbasan dhe Dibër – Tiranë – përcjellën lirin në robni.

Kjo qe kanga e fundit q'i këndoi Dibrani liris e lumntunis...

Të gjithë kishin ikë vetëm me petkat e shtatit dhe shumë kush pa asnjë dysh në xhep, pse s'kishin pas kohë..."

Në një nga faqet e Balkan Web më 17/4/2008, ora 08.54 më ra në sy një titull i bujshëm **"Harrohet prej 3 vitesh Hidrocentrali i Skavicës".** Më tërhoqi vëmendjen ndaj si të gjitha shkrimet që Verilindjen e shohin nga " sisët " dhe jo nga " goja ", e lexova dhe e rilexova me vëmendje. Zoti G. K. ishte i shqetësuar se një investim prej 600 milionë eurosh ka mbetur pezull ***" ndonëse bëhet me financim tërësisht të huaj dhe ka të bëjë me sektorin problematik të energjetikës "***. Ai është tepër i shqetësuar se ***" Qeveria shqiptare ka lënë në harresë zhvillimin e tenderit për dhënien me koncesion të HEC-it të Skavicës."***

Pas kësaj zoti K. nuk mungon të bëjë avokatin e konsorciumit italian TGK duke theksuar se ***" duhej të përbënte investimin më të madh të realizuar ndonjëherë nga kapitali i huaj privat deri tani, me fondet e veta..."***

Më tej kalon nga roli i avokatit në atë të inxhinierit projektues hidroelektrik dhe të zëdhënësit të firmave të mëdha private italiane të cilat janë të shqetësuara për vonesën pa asnjë justifikim të tenderit ***"ndonëse" Geoteknika "kishte paraqitur një studim të plotë për hidrocentralin e Skavicës si dhe projekt idenë përkatëse që ekonomizon terrenin".*** Nuk harron zoti Kondi të sqarojë edhe " meraket " e qeverisë, ***" me një zgjidhje origjinale edhe pse me një liqen më të vogël, pa u shtrirë në tokën maqedonase, jep të njëjtin rendiment si me liqen më të madh, ruan ambientin dhe konsideron veçoritë gjeologjike të tokës e zonës në përbërjen e materialeve të digës ".***

Nisur nga kjo bëra një shkrim me titull: **"Skavica mbyt një qytetërim të lashtë",** shkrim të cilin ia përcolla "Ballkan Web" dhe gazetës me pronar italian. Shkrimi nuk u botua dhe as u mor mundimi të më bënin një përgjigje njerëzore. Nuk kish si ta botonin dhe as të përgjigjeshin për faktin se gazeta është një gazetë italiane në gjuhën shqipe dhe nuk kishte se si të mbronte interesat e një treve të tërë që mbytej kundër interesave të bosëve italianë që bashkë me z. K. ishin skandalizuar pse ***" Qeveria shqiptare ka lënë në harresë zhvillimin e tenderit për dhënien me koncesion të HEC-it të Skavicës."***

Më 17 nëntor 2008, më në fund, e njëjta agjenci, njofton si "sihariq të madh" se METE, Ministria e Energjetikës dhe Tregtisë, ka shpallur tenderin për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës (!)

Dibra i nderuar miku im Ali do të mbytet. Qeveria shqiptare kërkon xhelatin për ta mbytë atë. Në qoftë se, në ata që ju përcolla më lart, dje orekset për shuarjen e Dibrës vinin nga Beogradi, sot ata vijnë nga Tirana. Mjerisht në zërin thirrës për mbytjen e Dibrës ka edhe dibranë "me grada" në qeveritë që brohorasin "Ta mbysim Dibrën", të majta e të djathta, se zërat për mbytjen e saj janë gjithëpërfshirës në politikën shqiptare.

Më 8 prill 2008 ju gjeta në Bibliotekën Kombëtare me një faqe gazete përpara me titull me germa të mëdha kapitale: "NDAL! PROJEKTEVE PËR SHITJEN DHE ASGJËSIMIN E PELLGUT TË DIBRËS", fiksuar edhe në një fotografi që po ta dërgoj.

Nuk do të ndalem në hollësitë e shkrimit tuaj botuar më 14 qershor 2005 në faqen 6 të gazetës "Rimëkëmbja", as edhe në shkrimet e tjera që janë përcjellë në "Rruga e Arbrit", "Dibra" dhe në ndonjë gazetë tjetër. Kush ka dëshirë ato mund t'i gjejë dhe t'i lexojë, veçanërisht dibranët "me grada".

Ti je historian dhe unë do të desha të di prej teje se çfarë dëmi i sillet historisë shqiptare me fshehjen nën ujë të historisë të një treve nga më të lashtat dhe nga më krenaret, një treve që ka nxjerrë Heroin tonë kombëtar Gjergj Kastriotin – Skënderbeun i cili, nga 26 beteja fitoresh të mëdha me zë në historinë e Shqipërisë dhe të Evropës kundër dy sulltanëve osmanlinj, 19 i ka zhvilluar me dibranët dhe në tokën dibrane. Vetëm kaq do të mjaftonte që Dibra të shndërrohej në një "Park Kombëtar Kujtimesh të Luftimeve të Mëdha", i mbrojtur nga shteti, madje edhe më gjerë.

Ju, i nderuar Ali jeni nismëtar dhe kryetar nderi i shoqatës ***"Për mbrojtjen e pronave dhe të mjedisit të pellgut të Drinit të Zi"***. Në një dëshmi para ministrit Ruli disa muaj më parë, në një takim me të në pranië edhe të një deputetit dibran të djathtë keni deklaruar: ***"Dëmi ekonomik qëndron në plan të dytë në krahasim me dëmin historik dhe etnokulturor që i shkaktohet Kombit."*** Duke ballafaquar rastin e Dibrës me atë të Vlorës ju theksonit, ***"...Vlonjatet kundërshtojnë ndërtimin e një TEC – i në krahinën e tyre, vetëm me pretekstin se ai u dëmtuaka atyre biznesin dhe turizmin. Krejt e kundërta ndodh me projektin e Skavicës. Këtu nuk bëhet fjalë për një " dëmtim " mjedisi, por me zhytjen përgjithmonë nën ujë të gjithë pellgut të Dibrës, më saktë zhdukjen e gjithë Dibrës dhe historisë së saj. Këtu nuk është fjala për cenim të pronës, por është fjala për zhdukjen e vendbanimit të një krahine të tërë, për zhdukjen e kujtimeve historike dhe varreve të të parëve, të trashëgimisë kulturore, bile mijëravjeçare, të rrënjëve etnokulturore të një krahine të tërë."***

Para ministrit ju deklaruat: ***"Në qoftë se shteti ka me të vërtetë interes kombëtar për ndërtimin e atij HEC – i, atëherë më parë duhet të ndërtojë një Dibër të re..."***

Ju, në shkrimin tuaj **"Ndal! Projekteve për shitjen dhe asgjësimin e pellgut të Dibrës"** ndaleni në faktin se fqinjët i kanë bërë dhe i bëjnë presion qeverisë shqiptare që të ndryshojë historinë e Shqipërisë sipas interesave të tyre. Grekët, më në fund, nën presionin e njohjes së marrëveshjes së asocim stabilizimit, arritën që të kenë varrezat e tyre në tokën shqiptare duke i dhënë një kuptim tjetër historisë. Nesër këtë gjë mund ta bëjnë edhe turqit duke kërkuar që të ngrenë një varrezë në kodrat e Gjoricës atje ku dibranët, me shpatë dhe pushkë me gjalmë, në vitin 1844 bënë, siç thotë kënga, "nand mijë vorre" të nizamëve të Hajredin Pashës. Po të njëjtën gjë do të kërkojnë edhe serbët për mijëra të vrarët e tyre në luftërat e paepura të dibranëve në dekadat e para të shekullit të kaluar për mbrojtjen e Dibrës nga synimi i tyre i afërt që vija e kufirit të kalonte nga Qafa e Buallit në Mërkurth të Lurë-Mirditës dhe ajo e largët për të dalë në Durrës e Shëngjin. Për ju projekti për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, ***"jo vetëm e ndryshon, por, bile, e përmbyt dhe e zhduk krejt Dibrën me gjithë historinë e saj".***

Më poshtë, duke hulumtuar në "ndërtimin e një Dibre të re" ju theksoni: ***"Në qoftë se do të ishte fjala që ai projekt të ishte bërë me të vërtetë për interesa kombëtare, atëherë Qeveria Shqiptare që e ka firmosur atë koncesion për HEC-in e Skavicës, le të ndërtojë më parë një qytet të ri, ashtu siç u ndërtua Kukësi i Ri dhe pronarëve që u përmbyten pronat tu sigurojë një sipërfaqe toke të barabartë me aq sa përmbytet, afro 64 kilometra katrore, pra të krijojë një Dibër të re...dhe pastaj të hyhet në bisedime me pronarët e ligjshëm të Pellgut të Dibrës për atë problem. Në qoftë se u plotësohen të gjitha kushtet e lartpërmendura, përfshirë këtu edhe të qenurit aksionarë të përhershëm të gjithë pronarëve e banorëve të zonës që përmbytet..."***

Këtu i dashur Ali ke harruar të shtosh se duhet të ndërtojë shteti edhe një varrezë ku të varrosen eshtrat e qindra mijë dibranëve se ata që do të ikin nuk do t'i lënë eshtrat e të parëve të mbyten e mbulohen nga llumi i harresës.

Më sipër e treguar pak ëndërrues dhe ke dalë jashtë realitetit të kohës që jetojmë dhe shoqërisë që po ndërtohet dhunshëm me synimin e fitimit maksimal. Ju në shkrimin tuaj keni llogaritur, në bazë të kostove financiare të deklaruara, se për 64 kilometra katrore tokë të rrëmbyer e të mbytur ofrohen 41.3 milionë euro***. "Italianët,*** vreni ju***, kanë vlerësuar Pellgun e Dibrës, me 41.3 milionë euro, që për 64 kilometra katrorë të sipërfaqes që parashikohet të përmbytet, i bie një vlerë prej rreth gjysmë euroje për metro katror..."***

Kalemxhinjtë e kapitalit shfrytëzues deri në palcë të vendeve të tjera e kanë mësuar se si rezultat i lëvizjes masive të dibranëve drejt Tiranës e Durrësit pas viteve '90-të (ikje disa herë më e madhe pas asaj të vitit 1913 nga pushtimi serb i trojeve shqiptare) vlera e tokës më pjellore në Dibër, tokë e cila është në planin e përmbytjes, rrotullohet nga 50 – 100 lekë. Kaq është kocka që ata japin. Ndërsa për atë që thua për një "Dibër të Re", për 64 kilometra katrore, apo 6400 hektarë tokë për të përmbyturit dhe për varrezat që shtova unë, harroje.

Shënim i redaksisë

Letra e hapur e bashkëpunëtorit tonë, Abdurahim Ashiku, drejtuar intelektualëve dibranë, dhe në veçanti, Presidentit të shoqatës "Për mbrojtjen e pellgut të Drinit të Zi", trajton një problem shumë madhor për Dibrën dhe dibranët. Problemi nuk është vetëm lokal, është gjithkombëtar.

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se Hidrocentrali i Skavicës është një vepër "madhore", por ajo nuk duhet të kthehet një një vepër "mizore". Ndaj, para se të jetë vonë, të gjithë duhet ti japin opinionet e shkruara, në radhë të parë specialistët që përmendën në këtë shkrim dhe më pas gjithë qytetarët. Në mënyrë që të bëhet ajo që është më e mirë për Dibrën dhe Shqipërinë.

Gazeta do të mirëpresë dhe do botojë çdo opinion lidhur me këtë problem, duke mos preferuar të bëhet palë në këtë debat, por duke rezervuar të drejtën të japë një opinion të saj, vetëm pasi të kenë folur më parë specialistët.



Në foto: Ali Hoxha

debat

Unë fola dhe shkrova i nderuar Ali. Po e lë fjalën time në Odën Dibrane, në Universitetin e Dibrës, për ta marrë e thënë kushdo, nga çdo hapësirë e globit ku jeton, me gojë e me zë të lartë...



Skavica. Foto: Sven Jacobs.
Foto është ilustruese dhe nuk ka të bëjë me përmbajtjen e shkrimit

Sot në Shqipëri nuk ka një metër katror tokë të lirë nga pronarët e ligjshëm dhe të kundërligjshëm, tokë e cila vlerësohet jo me një gjysmë euroje për metro katror por me njëqind. Nuk është koha kur tokat ishin "pronë shtetërore" dhe shteti i merrte "të mbyturit" e Ulzës e i zbriste në Mamurras e Thumanë, të mbyturit e Fierzës i ngjiste në Qytetin e Fajzave duke i punësuar në ndërmarrjen bujqësore të Krumës, në gjeologji, miniera etj, të mbyturit e Banjës i zbriste në vila të ndërtuara apostafat për ta mes pishave, vetëm njëqind metra larg detit dhe i punësonte në Ndërmarrjen Bujqësore të Hoxharës. Harroje atë që shkrove i nderuar Ali. Shteti ka vendosur ta mbysë Dibrën në interesa të një kompanie të huaj fituese e tenderit që ka shpallur duke u lënë dibranëve alternativën e vetme për të shpëtuar, daljen me not në breg dhe ngrohjen në diell, në qoftë se do të ketë diell.

Ti je dibran i nderuar Ali me rrënjë në një fshat që i ka dhënë kombit kujtesën e masakrës më të madhe në historinë e Shqipërisë që njihet me emrin e dhimbshëm "Masakra e Çidhnës", qyteti-kështjellë që përjetoi masakrimin nga shpata e pushtimit osman të më se dhjetë mijë shqiptarëve në rezistencën e fundit pas vdekjes së Skënderbeut. Ti je historian dhe për krimin historik të mbytjes së Dibrës duhet të ftosh në tryezë njerëz që i dinë mirë gjërat, të ftosh autorin e veprës madhore për Skënderbeun - Kristo Frashërin, njeriun që më shumë se kushdo tjetër i ka qëndruar pranë historisë së lashtë dhe të re të Dibrës, të ftosh historianin dhe politikanin Pëllumb Xhufi, të ftosh arkeologun-nënkryetar të Kuvendit të Shqipërisë Neritan Ceka... dhe të tjerë për ta thënë fjalën e tyre dhe për t'i thënë ndal krimit të shuarjes së një treve dhe të historisë së saj.

Unë nga ana ime, desha të ftoj në një tavolinë debati publik, jo si specialist, por si gazetar, si një njeri që i njeh burimet energjetike të Dibrës, specialistë të hidroenergjisë me në krye akademikun, projektuesin e hidrocentraleve të mëdhenj të Shqipërisë, njeriun që më mirë se kushdo në Shqipëri i njeh projektet dhe potencialet hidroenergjetike të vendit dhe besoj edhe të Dibrës, Farudin Hoxhën. Do të desha të ftoj inxhinierin e talentuar dibran Elmas Xhediku, kryeinxhinierin e fundit të ndërtimit të një hidrocentrali shtetëror në Shqipëri, njeriun që drejtoi me kompetencë punimet e hidrocentralit të Banjës, njeriun që i mbytet vendlindja e tij, Zall-Dardha, të ftoj ata që bënë projektin e ndërtimit të hidrocentraleve të vegjël lokalë mbi veprat ujore të Dibrës e që dolën në përfundimin se Dibra nga 15 milionë kilovat-orë energji që prodhonte në vitet '80-të mund të prodhojë 220 milionë kilovat-orë, me mundësinë e ngrohjes dhe gatimit me energji elektrike të tërë krahinës, inxhinierin hidroteknik Kliton Rusi dhe atë elektrik Bardhok Rajta.

Do të desha të komunikoj në një mjedis debati televiziv edhe me mbrojtësin më konsekuent të mjedisit shqiptar zotin Xhemal Mato.

Dua që "pretencën për mbytjen e Dibrës" ta bëjnë jo shtetarët por shkencëtarët.

Dibra ka një potencial ujor dhe basen ujëmbledhës nga më të mëdhenjtë (në mos më të madhin) në të gjithë rrjedhën e lumenjve, basen i cili fillon nga Struga me Drinin e Zi, në Dibër të Madhe me Radikën dhe degëzimet e tjera. Në të majtë të rrjedhës së Drinit të Zi ajo merr ujërat e maleve të Gollobordës nëpërmjet përrenjve e burimeve ujëgjallë të Tuçepit, Okshtunit, Bulqizës, Murrës, Setës dhe Mallës. Në të djathtë ajo mbledh ujërat e basenit të Bellovës, Deshatit, Gramës dhe Veleshicës.

Dua që t'i pyes njerëzit e mëdhenj të shkencës hidroelektrike të vendit se çfarë potencialesh ujore dhe energjetike fshehin këta burime ushqyese të Drinit të Zi në qoftë se ata futen në skemën e shfrytëzimit të forcës së ujit.

Ti e njeh Setën i dashur Ali, e njeh jo vetëm nga kanali që ushqen një hidrocentral që më ngjan se është i mjaftueshëm për të furnizuar aktualisht me energji elektrike fshatrat e Çidhnës dhe të Sinës. E njeh sepse me siguri në fëmijëri ke zbritur monopatin e thepisur dhe ke freskuar trupin ditëve të nxehta të verës në ujërat e saj. Sikur t'i pyesnim bashkë, madje të ftonim edhe ekonomistin e njohur, ish guvernatorin e Bankës së Shqipërisë çidhnakun Shkëlqim Cani, ndihmësin e kryeministrit Berisha, ekonomistin e talentuar me rrënjë lindje në Shumbat, Selami Xhepa dhe të tjerë, çfarë vlerash do të kishte që pikërisht pak më lart se godina e hidrocentralit të vogël të ngrihej një digë hidrocentrali mbi Setë? Unë do të ftoja edhe drejtues të Ministrisë së Turizmit që nga sheshi mbi trapezin e digës së liqenit të Setës të më përgjigjeshin se a nuk do të ishte e udhës që prej atje të lundronin midis atij monumenti natyror, por edhe të një monumenti trimërie për hapjen e kanalit të Setës në verën e vitit 1967, varka-gondola që do t'i merrnin turistët për t'i zbritur në Gurë-Lurë e nëpërmjet një teleferiku për t'i ngjitur në sheshin tek Liqeni i Luleve? Do të kishim disa gjëra bashkë: një ujëmbledhës të madh, dritë elektrike, veprimtari turistike. Po të njëjtën gjë këtyre, dhe të tjerë, do tua bëja edhe në qoftë se do të ngrinim të tillë hidrocentrale me liqene "turistikë" mbi Mallë, Murrë, Veleshicë, Zallin e Okshtunit etj. Dibra me një potencial të tillë hidroenergjetik, me një luginë pjellore ku molla, dardha, qershia, vishnja, arra, kumbulla, gështenja janë në "shtëpinë e vet"...dhe me prime e një blegtori të shëndetshme, me liqene të mrekullueshëm malorë si ato të Lurës dhe Kacnisë, me bjeshkë madhështore si ato të masivit të Korabit...do të ishte një perlë e maleve tona.

Në shoqëri të këtyre specialistëve, për të vënë dorën në zemër dhe për të thënë fjalën e tyre "Ndal mbytjes së Dibrës!" do të ftoja edhe deputetin Farruku për ta pyetur në se më e udhës është mbytja e Muhurrit, e vendlindjes së tij apo ndërtimi i një hidrocentrali mbi Murrë me vlera të barabarta me ato të Setës.

Po në të njëjtën shoqëri do të ftoja edhe deputetët e tjerë ngjitur në Kuvend me votën e popullit të Dibrës, zotërinjtë Kaleci, Shehu dhe Abazi

Për t'i pyetur në se më mirë është që mbi degëzimet e Drinit të Zi, në të dy krahët e tij, që nga Zalli i Okshtunit e deri në Veleshicë të krijoheshin ujëmbledhës dhe hidrocentrale dhe me ta edhe pika turistike në këmbë dhe drejt majave të maleve të Dibrës me Korabin në ballë apo ta mbysnim gjithë luginën pjellore të Dibrës në rritje të fitimeve të një firme të huaj që veç parasë nuk i hyn asgjë në sy.

Pasi të merrja një përgjigje "teknike" dhe "politike" do të desha të shuaj kuriozitetin me një pyetje komplekse: Sa do të ishte volumi ujëmbledhës i të gjithë këtyre hidrocentrale mbi degëzimet e Drinit të Zi dhe cili është raporti i ujëmbledhjes së tyre me "kazanin" e Skavicës? Sa do të ishte energjia elektrike e prodhuar nga këto ndërtime "të vogla" në raport me atë që do të prodhojë Skavica? Nuk e di, ndoshta gaboj me hamendjet e mia por më ngjan se raportet do të jenë një me një dhe sasia e ujit që do tu jepet hidrocentraleve të Fierzës, Komanit, Vaut të Dejës dhe "Bushatit" në kohë piku do të ishte po aq, madje e sigurt, sa ajo e Skavicës. Them "e sigurt" pasi unë dyshoj se kompania e huaj do ta mbaj fjalën që kur niveli në Fierzë të arrijë pikën minimale do ta ndërpresë prodhimin e energjisë elektrike për të hapur portat për boshatisjen e ujëmbledhësit mbasi kjo ka qenë (nuk e di në se edhe tani është) vendi i hidrocentralit të Skavicës në raport me hidrocentralet e tjerë. Kam frikë se do të ndodhë si një herë e një kohë kur Maqedonia nuk i hapte portat e hidrocentralit të Spiles dhe shteti i diktaturës e kërcënoi me ultimatumin: "Në qoftë se nuk hapni portat atëherë ne do të hapim një tunel për ndërtimin e një hidrocentrali në Përrenjas dhe nivelin e liqenit të Ohrit do ta zbresim në pikën ku Drinin e Zi nuk do të rrjedhë më ujë". Një ultimatum i tillë për kompaninë italiane shfrytëzuese të ujit të Skavicës nuk vlen. Ajo, e shumta, mos prodhimin e energjisë elektrike si pasojë e hapjes së portave, do të kërkonte ta kompensonte me "shitje uji".

Por, në lidhje me ujin, mbushjen e rezervuarit ka një problem që nuk ka se si të mos ngjallë kontradikta mes firmës së huaj dhe shtetit shqiptar, Dikur thuhej se mbushja e rezervuarit do të kërkonte kohë, jo muaj por vite. Gjatë kësaj kohe sistemit të hidrocentraleve mbi kaskadën e Drinit, pronë, tani për tani, shtetërore do t'i mungojnë tërësisht prurjet e Drinit të Zi, prurje që janë shumë më të mëdha se sa prurjet e Drinit të Bardhë. Gjatë kësaj kohe Shqipëria, pa alternativë të shpejtë burimesh energjetike ujore e termike, do të përjetojë një errësirë marramendëse. Mbytja e Dibrës nga hidrocentrali i Skavicës do të reflektojë me "mbytje" energjetike në mbarë Shqipërinë.

Por le të ndalemi edhe në një çast tjetër, atë të ndërtimit të hidrocentralit dhe të mbushjes së rezervuarit.

Nuk ka ndonjë të dhënë për brigjet e pasqyrës ujore të rezervuarit përveç asaj që është deklaruar si ***"zgjidhje origjinale ... me një liqen më të vogël, pa u shtrirë në tokën maqedonase".*** (Sa largpamës jemi, nuk shqetësohemi se po mbytet një trevë e tërë, po mbytet fusha e Gjoricës dhe fushëzat e fshatrave për rreth, por shqetësohemi se po mbyten disa dhjetëra dynymë në bërrakat e fshatrave shqiptarë nën Maqedoni!)

Po përfytyroj një skenë miqsh e miqësish i dashur Ali. Ti je në Çidhën. Unë jam në Zdojan. Të dy kemi në sy përpara Dibrën e përmbytur. As ty dhe as mua nuk na ka prekur uji as tokat, as shtëpitë dhe as na ka mbytur varret e të parëve tanë. Në këtë komoditet indiferent mua më shkon mendja që të vij mik tek ti, ta pi një kafe në atë kullën e hershme të gjyshërve të tu, t'ju marr përkrahu të kalojmë anës kullës në tri pode të Krrashëve për të kundruar liqenin poshtë këmbëve. Nuk e di në se burimet ujëvarës të Sopanikës do të jenë mbytur apo jo por, sidoqoftë, syri do të na ndalet mbi ujë e kujtesa nën ujë. Do të na ndalet në Sinë, diku aty ku është muzeu i vendlindjes së Skënderbeut, në "Kuvendin e Arrasit" e më tej te "Pusi i Gjonit", "Ara e Gjonit", "Fusha e Torviollit" dhe kujtesa historike për fitoren e shqiptarëve, me përmasa të fitores më të madhe botërore të kohës...Ato janë zhytur në ujë e mbuluar me llumin që shirat rrëmbyes të vjeshtës e të pranverës mbledhin nga Gjagjishti në Korab dheun e të gjitha ngjyrave. Nuk e di në se do të jetë "ishull" apo "gadishull" Suka e Arrasit, kodra e bukur që dominon tërë pamjen në veri, lindje e jug, e merr e ta jep Dibrën mbi pëllëmbë duarsh të hapura, ashtu siç i falemi Zotit. Por një gjë di: Unë nuk mund të vij ta pi një kafe me ty dhe të dal shëtitje ndash poshtë e ndash lart Gjalicave. Nuk mund të vij sepse ura e hekurit në Muhurr do të jetë mbytur dhe të "Nëntë Malet e Dibrës" nuk mund të jenë më të Dibrës. "Rruga e Rinisë" e nisur në vitin 1946 është e mbytur dhe mbi bregun e ujëmbledhësit nuk ka as rrugë dhish që të lidhë tërë "Malet e Dibrës". Tërë fshatrat në perëndim, që nga Hoteshi e deri në Bardhaj Reç do të jenë përfundimisht të ndarë nga Dibra. Do të ndodhë një shpërndarje administrative e Dibrës. Lura me siguri do të shkojë me Mirditën. Me të mund të bashkohet edhe Çidhna e Dardha. Reçi mund të bashkohet me Arrnin e të bëhet "mal" i Kukësit. Katër Grykët e Murrës do të bashkohen me Matin. Nuk e di se me kë do të shkojnë Muhurri dhe Luznia, me Bulqizën apo me Matin. Dibrës do t'i mbetet vetëm një rrip majëmalesh që nga Kërçini në Korab e Sorokol dhe një "prehër" tokë...

...E ndjen se sa tragjike do të jetë një ndarje e tillë i nderuar Ali? E ndjen se si ai ujë i amullt mbuluar me leshterikë të gjelbër mbyt dhe ndan përgjithmonë kohët, njerëzit, miqësitë, krushqitë. Nuk të duket ky brez ujor më i tmerrshëm se "brezat e butë - klonet elektrikë" që në kohë të shkuara ndanin kufijtë? Nuk të duket kjo ndarje më e tmerrshme dhe më e kobshme se sa ndarja e dhunshme e Dibrës –qytet me Dibrën-fshat nga Konferenca e Londrës e vitit 1913? Nuk të duket kjo si në tregimin e fillimit të këtij hulumtimi për "Barbaritë serbe në Dibër" në fillim shekullin e kaluar?

Mos donë të thuash se "shtoj dhe ekzagjeroj" i dashur Ali? Ma korrigjo të lutem shikimin tim për "Dibrën e mbytur". Jo vetëm ti por të gjithë ata që i thonë vetes intelektualë, dibranë qofshin apo jo, ata që u dhemb në shpirt çdo pëllëmbë e kësaj toke të mbrojtur me gjak, çdo skelet nëntokë me plagë nga shpata e plumbi ngulur thellë në gjoks nga armiqtë e të gjitha kohërave.

Unë fola dhe shkrova i nderuar Ali. Po e lë fjalën time në Odën Dibrane, në Universitetin e Dibrës, për ta marrë e thënë kushdo, nga çdo hapësirë e globit ku jeton, me gojë e me zë të lartë...

Shënim: Lexoje, reflekto, dorëzojua miqve dhe armiqve të Dibrës!

Athinë, Nëntor 2008

Mbyllet festivali Oda Dibrane, që tashmë është kthyer në një festival tradicional, duke u renditur për nga rëndësia pas atij të Gjirokastrës.

"Oda Dibrane", vlerësohen me çmim grupet folklorike të Peshkopisë, Tetovës dhe Giurgiu-Rumani

Përfundoi edicioni i 14-të i festivalit folklorik "Oda Dibrane" 2008. Për tri net me radhë, në Pallatin e Kulturës të qytetit të Peshkopisë, grupet folklorike nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi etj., kanë shpalosur para artdashësve dibranë vlerat më të mira burimore folklorike të trevave nga kanë ardhur. Kështu, në natën e tretë të ditës së shtunë konkurruan grupet folklorike të Strugës, Rumanisë, Tetovës dhe Vlorës. Nata finale u ndoq nga një numër rekord shikuesish dhe të ftuarish të shumtë. Me interes të veçantë në këtë natë finale u ndoq ansambli artistik "Giurgiu", Rumani, i cili kishte bërë një figurë të mirë në përshëndetjen që dha natën e parë të hapjes së këtij festivali. Interesimi i madh për natën finale lidhej edhe me ndarjen e çmimeve nga juria për grupet pjesëmarrëse. Kështu, mes duartrokitjeve të të pranishmeve, juria nën drejtimin e Rexhep Çelikut nderoi me çmim të parë grupet folklorike të qytetit pritës të Peshkopisë, Tetovës dhe ansamblin folklorik "Giurgiu" të Rumanisë, i cili bëri një figurë shumë të mirë në interpretimin me nivel tepër të lartë artistik të këngës dhe valles burimore folklorike rumune. Gjithashtu, përveç çmimeve të para për tri grupet fituese, juria akordoi çmime edhe për interpretimet më të mira të këngës dhe valles së dhënë nga grupet pjesëmarrëse. Në përfundim, kryetari i jurisë, Rexhep Çeliku, shprehu vlerësime dhe konsiderata për të gjitha grupet dhe pjesëmarrësit në këtë festival, për përgatitjet mjaft serioze dhe me nivel të lartë artistik që ata kishin bërë, që padyshim, siç tha ai, do të shërbejnë si një bazë mjaft e mirë për rritjen e mëtejshme të nivelit të këtij festivali, që tashmë është kthyer në tradicional, duke u renditur për nga vlerat dhe gjithçka tjetër pas atij të Gjirokastrës.





Kryetari i jurisë, Rexhep Çeliku, shprehu vlerësime dhe konsiderata për të gjitha grupet dhe pjesëmarrësit në këtë festival, për përgatitjet mjaft serioze dhe me nivel të lartë artistik që ata kishin bërë, që do të shërbejnë si një bazë mjaft e mirë për rritjen e mëtejshme të nivelit të këtij festivali



Fotot: Grehans Uka

Vështrime

Në portat e kështjellës natyrore të Bulqizës

Nga: **YMER KETA**

Bulqiza, si krahinë e veçantë në zonën verilindore të Shqipërisë, është disi tipike. Ajo përfaqëson diçka shumë të rëndësishme. Atë Zoti e ka bekuar. Me ata bukuri e pasuri të panumërta dhe njerëzit e mrekullueshëm të saj.

Në vështrimin gjeometrik, gjeografik dhe ekologjik, Bulqiza përbën një kaleidoskop të mrekullueshëm të natyrës, gati një lloj principate të pashembullt ekologjike, ku malet hijerëndë, fushat, pllajat në këto male, si dhe thesari i mineralit të Kromit që fshihet në barkun e saj i kanë bërë mjaft tërheqës investitorët e huaj. Gjithashtu burimet e pashtershme ujore përbëjnë një unitet të spikatur dhe bazën kryesore të zhvillimit ekonomik të kësaj treve.

Në portat kryesore të Urës së qytetit me Harqe dhe atë të Qafës së Buallit kanë hyrë e dalë grabitqarë lindorë e perëndimorë, luftëtarë e prijës popullorë, studiues, qiraxhi e kurbetçinj, ku këto dy porta hyrje e dalje e kanë bërë dhe më të rëndësishme këtë krahine që ka lidhur Dibrat me Matin, Mirditën, Lezhën e Shkodrën dhe Perëndimin. Në këtë luginë heroi dhe strategu legjendar



Foto. **Shpëtim Cami**

Gjergj Kastriot Skënderbeu, në tokën e tij në krye të ushtrisë së vet, luftoi dhe doli fitimtar kundër hordhive të shumta turke, si në betejën e Torvjollit dhe dy beteja të Vajkalit.

Në këto dy porta mund të hysh pa trokitur, duke njohur fytyrën dhe thelbin e saj. Nga njohja mund të magjepsesh pambarimisht, ku mëson për luftërat që janë zhvilluar në këtë krahinë, jo vetëm në kohën e Skënderbeut, por dhe më pas, në kohën e Fejzë Cangës, Dalip Karajit e të Mehmet Duriçit. Ajo është gjithnjë e përhershme dhe një estetike e gjallë e sendeve dhe e qytetërimit iliro-shqiptar, një stacion diturak i mijërvjeçarëve dhe i kënaqësive të veçanta të banorëve, të udhëtarëve dhe studiuesve. Çdo tregim mitologjik për Bulqizën i paraprin historisë së saj plot motive e kontraste.

Jo më kot, kronikania euridite bizantine Ana Komnena e quan krahinën e Bulqizës "Kështjellë natyrale" të mbrojtur nga të gjitha anët. Nuk është thjesht një metaforë e skajshme, por po të ngjitesh në majën e malit të Temles, tek pika trigonometrike në lartësinë 1703 m të jepet mundësia të filmosh me atë syrin tejvështrues (të dy Dibrat) me fshatrat e saj, ku duken si në pëllëmbë të dorës. Aty mund të vështrosh krahinën e Bulqizës në lartësinë e historisë së saj, në ajrin e shekujve, si të dalë nga frymëzimi poetik i "Bagërit, Stërmillit apo i Fishtës". Në Bulqizë nga të katër anët, të rrethojnë metaforat e historisë.

Botimeve të fundit në fushën e letrave, për historinë, kulturën, vlerat dhe pasuritë e saj tashmë u shtohet edhe interesi për mineralin e Kromit, që sot ndodhet në tavolinat e biznesit botëror. Gjithashtu në shërbim të biznesit vendas të atyre që kanë interes për të investuar në këtë krahinë (zonë mineral-mbajtëse) janë dhe burimet e shumta (Hidrike) ujore e me projekte konkrete të përgatitura, ndaj biznesmenët bulqizak duhet të mos humbin kohë, për këtë mundësi të përshtatshme përfitimi e prodhimi energjie elektrike.

Ky reliev përmban një informacion mjaft të gjerë e të pasur, si për atë që vjen dhe e viziton për herë të parë këtë krahinë dhe për ata që pretendojnë se e njohin Bulqizën me rrethinat e saj. Ilustrimet e zgjedhura, adresat e institucioneve të rrethit dhe të mjediseve, të shërbimit e të pushimit e bëjnë atë mjaft praktike për këdo, pasi kohët e fundit po i vjen në ndihmë dhe ndërtimi i segmentit të "Rrugës së Arbrit" nga firma e ndërtimit Albavia, e cila gjatë punës ka hequr disa nga objektet e kultit që përkujtonin ngjarje historike të luftërave me emër si Beteja e Vajkalit dhe atë të LNÇL lapidare.

Në valën e ndërtimeve të mëdha dhe në përkujdesjen e qeverisë aktuale për këtë zonë, në qoftë do të zbatohet projekti i nisur në vite më parë për "Rrugën e Arbrit", Bulqiza do të bëhet lagje e Tiranës, me një largësi prej 70 km, ku do të jetë më afër qendrave industriale, e do lidhet me Evropën Qendrore e Perëndimore.

““**Aurora Group**”, *tha në vlerësimin e tij, presidenti i organizates B.I.D, z. Jose Pietro,* **është shndërruar në një kompani model për përhapjen e kulturës së cilësisë në botën e biznesit në Shqipëri.**

Presidenti i Kompanisë, dibrani Rakip Suli, merr çmimin në një ceremoni madhështore në Londër



Në foto:
Presidenti i Aurora Group, z. Rakip Suli duke marrë çmimin nga Presidenti i B.I.D, Jose Pietro.
Londër, 24 nëntor 2008

KRITERET MBI TE CILAT U DHA ÇMIMI:

- Lidershipi
- Qëndrueshmëria dhe rritja e tregut
- Inovacioni dhe teknologjia
- Shërbimi ndaj klientit
- Angazhimi për kualitet dhe përmbushje standardesh
- Satisfaksioni i punonjësve
- Shërbimi dhe satisfaksioni i klienteve

Aurora Group vlerësohet me **“Trofeun e Artë Ndërkombëtar të Cilësisë”**

“Aurora Group” vlerësohet me “Trofeun e Artë Ndërkombëtar të Cilësisë”. Çmimin e mori Presidenti i “Aurora Group”, z. Rakip Suli, një një ceremoni madhështore të zhvilluar javën e fundit të nëntorit në Londër. Mbi 500 veta ishin të pranishëm në mbrëmjen gala të zhvilluar më 24 nëntor në Londër, në Gouman Tower. Gjatë gjithë paradites u zhvilluan veprimtari të ndryshme, takime biznesi, intervista, biseda, ndërsa në orën 6 pasdite deri në orën 11 u zhvillua mbrëmja gala. Në këtë veprimtari marrin pjesë përfaqësues të biznesit të mbi 74 shteteve të botës. Gjithashtu, pjesmarrës ishin diplomatë dhe trupa diplomatike të vendosura në Londër, protagonistë dhe menaxherë të artit, akademikë të fushave të ndryshme, profesorë të ekonomisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo veprimtari u ndoq pa ndërprerje nga 16 media publike nga e gjithë bota, që kanë në fokus biznesin.

Çmimi, me të cilin u nderua “Aurora Group”, jepet pas një selektimi dhe votimi që u bëhet konkurentëve nga një staf ekspertësh ndërkombëtarë. Konkurentët e këtij çmimi përzgjidhen nga një staf ekspertësh nga e gjithë bota, duke pasur për bazë vlerësimin dhe çertifikimin e biznesit mbarëbotëror.

Ekspertët ndërkombëtarë të biznesit ndjekin një sërë kriteresh korrekte mbi bazën e të cilave jepet edhe çmimi “Trofeu i Artë Ndërkombëtar i Cilësisë”.

Disa nga kriteret janë lidershipi i kompanisë, aftësia e tij menaxhuese dhe drejtuese, qëndrueshmëria dhe rritja e tregut në vitet e fundit, futja e teknologjive të reja dhe novatore në biznes, shërbim ndaj klientit në sdandarde të përcaktuara nga ISO, angazhimi i kompanisë për përmbushje të standardeve të prodhimeve dhe rritjes së kualitetit, etj.



Në foto: Presidenti i Aurora Group, z. Rakip Suli dhe zv Presidenti i B.I.D.

Jo vetëm këto, por edhe krijimi i hapsirave të punonjësve të kompanisë për të punuar të pavarur, duke lënë hapsira për krijueshmëri e vendimmarrje, duke i vlerësuar ata në arritjen e sukseseve të kompanisë, është një nga kriteret e tjera që kanë parasysh ekspertët në përzgjedhjen e fituesve.

Gjithashtu, një nga kriteret kryesore është edhe shërbimi ndaj klientëve dhe satisfaksioni që u jepët atyre.

Pas këtij vlerësimi, “Aurora Group” u nderua me Trofeun e Artë të Cilësisë, çertifikatën e cilësisë, duke nënshkruar edhe deklaratën për angazhimin për përmbushjen e standardeve në aktivitetin e saj.

Presidenti i “Aurora Group”, z. Rakip Suli, duke marre çmimin tha se “ky çmim është mjaft i rëndësishëm për “Aurora Group”. Ajo ka më shumë vlerë, pasi i akordohet nga një organizatë mjaft e njohur e vlerësimit të biznesit. Ne do të punojmë edhe në të ardhmen për rritjen e standardeve të shërbimit dhe cilësisë, duke u bërë kështu një nga pararojat e biznesit shqiptar në këtë drejtim.

““Aurora Group”, tha në vlerësimin e tij, presidenti i organizates B.I.D, *z. Jose Pietro*, është shndërruar në një kompani model për përhapjen e kulturës së cilësisë në botën e biznesit në Shqipëri. Në fund të fundit ky është dhe qëllimi i organizatës, të vlerësojmë dhe njohim kompani të cilat jane të angazhuara për të ofruar cilësi e inovacion. Kompania B.I.D. ushton aktivitetin e saj që në vitin 1984, duke certifikuar dhe nderuar kompani nga e gjithe bota për rezulatet e tyre.

Pas këtij çmimi, “Aurora Group” shndërrohet menjeherë në anëtare bordi.

Ky event organizohet çdo vit në qytete të rëndësishme si: New York, Londër, Paris, Gjeneve, Frankfurt, etj.

Në këtë ceremoni gala, përvec Presidentit të Aurora Grup, z. Rakip Suli, merrnin pjesë edhe drejtori i kompanisë, Njazi Marku.

Korresp. “Rruga e Arbërit”

PROFILI I KOMPANISË

Aurora Group ka filluar aktivitetin e saj në vitin 1996, e krijuar dhe drejtuar nga z. Rakip Suli, President dhe Administrator.

Aurora Group e ka nisur aktivitetin e saj në tregtimin e materialeve të ndërtimit, në projektimin, zbatimin, rikonstruksion dhe në finitura të mjediseve të brendshme dhe të jashtme.

Nën administrimin e z. Rakip Suli, Aurora Group filloi të shtrihej me një shpejtësi të madhe në të gjithë territorin e vendit. Kjo, falë cilësisë së materialeve që Aurora Group tregton, si dhe stafit të saj të specializuar.

Me këtë ritëm, Aurora Group merr ekskluzivitetin e kompanisë amerikane USG DONN për Shqipërinë, Kosovën e Maqedoninë. Kjo ishte një arritje e madhe dhe një mundësi më shumë për klientët e saj.

Gjithashtu, Aurora Group bashkëpunon me kompanitë europiane më prestigjioze si: Usg, Metaxiotis, La Farge, KNAUF, Rigips, CKM, Akifix, Heraklith, Rockfon, Bitum, Stir xps, Permabase, Onduline, Ursa, Decora, Pratt & Lambert, Neoboard, Petridhis, Ergis, Real Generator, PFT, etj., prodhimet e të cilave janë të lincensuara sipas standardeve europiane ISO 9001.

Për t’ju gjendur më pranë kërkesave gjithnjë e në rritje të klientëve të saj, çdo vit Aurora Group vjen në treg me një shumëllojshmëri produktesh.

Në vitin 2006, Aurora Group ka ndërtuar në autostradën Tiranë - Durrës, ambjente me parametra bashkëkohore. Në një sipërfaqe prej 5000 m2, ajo ka magazinën me një sipërfaqe 3000 m2, ekspozitën 500m2 si dhe zyrat 250 m2, duke ju ofruar kështu klientëve lehtësi në përzgjedhjen e mallrave dhe produkteve.

Mjafton të filloni me Aurora Group dhe do të ndjeheni më komod në mjediset tuaja.



Zbrazja e qytetit është e dëmshme për biznesin, për shkollat, shëndetësinë, gjykatat dhe sektorët e tjerë, por edhe arka e shtetit do të zvogëlohet në mungesë të tatimpaguesve

Dibra e Madhe po plaket

Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës së Madhe i pyetur për natalitetin në komunën që drejton, deklaroi se "fatkeqësisht jo të gjitha komunat janë paraparë në Ligjin e ri për stimulimin e natalitetit në Maqedoni".

"Unë nuk jam aspak dakord me këtë ligj, i cili nuk është i barabartë për të gjithë qytetarët e Maqedonisë dhe si i tillë është diskriminues. Më shumë se dy decenie nga Dibra e Madhe ka një mërgim të paparë të gjeneratës gjenerative, gjeneratës e cila ka aftësi të shumohet dhe ta ripërtërijë popullatën. Në dhjetë vitet e fundit në lindjet e fëmijëve në komunën tonë vërehet një disbalancë shumë e madhe në krahasim me para 10-15 viteve, kur në Dibër të Madhe kishte diku 900 lindje në vit, duke llogaritur edhe gravitimin nga Komuna e Zhupës dhe nga fshati Skudrinjë", tha Fida.

Por vetëm nga komuna e Dibrës së Madhe, sipas tij, asokohe kishte mbi 600 lindje në vit. Aktualisht të dhënat numerike tregojnë se në komunën tonë përafërsisht ka afër 200 lindje në vit, që është numër shumë i vogël.

Duke folur për treguesit e kësaj gjendje , ai shton se: "Sot në shkolllat fillore "Vllazrim Bashkim" dhe "Said Najdeni" na paraqiten nga 50 nxënës të klasës së parë më pak nga ata që janë lindur.

"Kjo do të thotë se nga lista e fëmijëve të lindur në Dibër të Madhe rezulton se rreth 100 fëmijë jetojnë në mërgim me prindërit e tyre dhe aktualisht nuk janë më banorë të Dibrës së Madhe. Ligjet që vlejnë për tërë Maqedoninë duhet jenë edhe për Dibrën e Madhe, sepse gjendja e natalitetit në komunën tonë është më e rëndë se sa në shumë komuna tjera ku me ligj u mundësohet të kenë stimulim nataliteti, që populata që ka mërguar, të plotësohet nga ata që janë të pranishëm duke e shtuar popullatën, në mënyrë që edhe Dibra e Madhe të përtërihet me gjeneratat që vijnë", thotë më tej Fida.


Argëtim Fida

Lidhur me hapat që duhet të ndërmerren në këtë drejtim, Fida shprehet se "intelektualët dibranë së bashku me OJQ-të dhe pushtetin vendor për këtë temë duhet të organizojnë një tryezë të rrumbullakët, ku ky problem do të elaborohet në mënyrë shkencore. Ndryshe nëse nuk ndërmerret asgjë, pasojat do të vërehen në decenien që vjen në kuptim të humbjes së vendeve të punës në arsim, në shëndetësi dhe në sektorët e tjerë, por nga kjo do të rezultojë edhe plakja e popullatës", shprehet ai.

Për shqiptarët, thekson ai, "plakja e popullatës, nuk ka qenë fenomen, por në vendet ku mërgimi i madh ka rrezikuar gjeneratën gjenerative, kjo paraqet problem shumë serioz dhe duhet të trajtohet në të gjitha instancat vendore e qendrore, për të gjetur zgjidhje dhe që efektet e dëmshme të mos na paraqiten në dhjetëvjetëshin që vjen".

Sipas tij, madje, "zbrazja e qytetit është e dëmshme për biznesin, për shkollat, shëndetësinë, gjykatat dhe sektorët e tjerë, por edhe arka e shtetit do të zvogëlohet në mungesë të tatimpaguesve".

"Dikur mërgimi ka qenë për shkaqe politike, thotë Fida, ndërsa pas pluralizmit mërgimi ndodh për shkaqe ekonomike".

> Në dhjetë vitet e fundit në lindjet e fëmijëve në këtë komunë vërehet një disbalancë shumë e madhe në krahasim me para 10-15 viteve, kur në Dibër të Madhe kishte diku 900 lindje në vit. Aktualisht të dhënat numerike tregojnë se në komunë përafërsisht ka afër 200 lindje në vit.

"Tranzicioni në komunën tonë ishte nga më të dhembshmit në Maqedoni. U mbyllën rreth 3000 vende pune, siç ishte Kombinati i Qilimave me 1000 vende pune, Ndërmarrja "8 Shtatori" me 200 vende pune, Kombinati Bujqësor "Progres", me rreth 250 vende pune, "Deplasti" me rreth 300 vende pune dhe shumë objekte tjera ekonomike. Nisma private në Dibër të Madhe ende nuk është fuqizuar, si vend kufitar me infrastrukturë rrugore të lënë pas dore, që me siguri nuk ka qenë edhe stimulim për të bindur investitorët e huaj të investojnë këtu" tha ai.

Ne si pushtet vendor aktualisht kemi përgatitur plane detaj dhe jemi duke biseduar me mërgatën tanë, që të vijnë të investojnë në vendlindje dhe ta zbusin papunësinë. Ata e kanë obligim moral dhe patriotik ta ndihmojnë Dibrën e Madhe, me çka do të ndikojnë edhe në zbutjen e plakjes së qytetit dhe të qëndrimit të gjeneratave të reja në vendlindje", tha në fund kryetari Argëtim Fida.

Rexhep TORTE



Komuna me godinë të re

Argëtim Fida, kryetar I Komunës së Dibrës së Madhe lidhur me ndërtimin e godinës së re të kësaj komune, thotë se, "Si garniturë e re e pushtetit vendor gjetëm vetëm themelet dhe fillimin e punimeve të godinës së re të komunës në Dibër të Madhe. Edhe ato para për fillimin e punimeve në vlerë prej 250 mijë euro u akorduan asokohe kur BDI ishte në koalicionin e pushtetit qëndror. Në vitin 2005 vazhduam punimet dhe arritën me pjesën e konstruksionit me beton arme deri në katin e tretë. Me daljen e BDI në opozitë ishte vështirë që të sigurohen mjete për vazhdimin e punimeve. Në vitin 2008 Qeveria aktuale ndau mjete tjera financiare. Kështu që e kryem pjesën e karabinasë dhe të kulmit, vendosjen e dritareve e të fasadës dhe aktualisht punohet me intensitet të madh ku është duke përfunduar faza e parë e instalimeve elektrike, e nxemjes qëndrore, ujësjellësit dhe kanalizimit. Janë duke vazhduar punimet në suvatimin e objektit në pjesën e brendshme dhe nëse lejojnë kushtet atmosferike do të vendosim shtresat e dyshemesë, që deri në fund të këtij mandati t'i afrohemi përfundimit të objektit. Në këtë object të ri të komunës parashihet puna me sistemin njësportelik, ku qytetarët do të kenë shërbime të shpejta dhe të një cilësie të lartë".

Në pyetjen se cilat dikastere do të vendosen në këtë objekt të komunës, Fida, shtoi se,"Përveç zyrave të administratës së pushtetit vendor, sallës së Këshillit të Komunës, në këtë godinë do të vendosen edhe Njësia rajonale e Ministrisë së Bujqësisë, Agjensioni për Zhvillimin e Bujqësisë, Njësia rajonale e Ministrisë së Mbrojtjes, e Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria për Menaxhim me krizat, Agjensioni për Shpëtim, zyra e inspektorëve të ministrisë së ekonomisë dhe zyra e deputetit ku do t'i presë palët në ditën e caktuar. Përveç Drejtorisë së Kadastrës dhe njësisë rajonale të Ministrisë së Financave, të gjitha shërbimet e tjera qytetarët do të mund t'i marin në këtë godinë të re.

Ky është një sukses i madh i pushtetit vendor sepse bëhet fjalë për një objekt kapital bashkëkohot me afër 3000 metra katrorë që rrallë e ka ndonjë komunë në Maqedoni.

Sa i takon anës financiare, ai thekson se, "përkundër ndryshimeve që kemi bërë në projektin lidhur me kulmin që tu përshtatej kushteve klimaterike dhe me fasadën strukturale të sallës së KK, me ekonomizim maksimal do të mundohemi që ndërtimin e objektit ta përfundojmë me paratë e akorduara deritani, ndryshe do të detyrohemi të kërkojmë para shtesë nga Qeveria", tha në fund kryetari Argëtim Fida.

R.T.

Dibër- Tribunë e Myftinisë kundër drogës dhe alkoolit

Ta luftojmë drogën duke mos e përdorur

Në organizim të Myftinisë së Dibrës, u mbajt tribuna shkencore me temë "Droga, alkooli dhe rinia dibrane".

Xhemail Çupi, teolog në hapje të kësaj tribune shkencore, tha se: "Paqja, harmonia dhe dashuria të zotërojë në shpirtrat tuaj". Kriza sociale, ekonomike dhe shpirtërore që është duke na sunduar, kanë bërë që armiku më i madh i njerëzimit të jenë droga dhe alkooli. Kjo tribunë ka për qëllim të informohemi për shkaqet, rrethanat që i favorizojnë këto dukuri devijuese të shoqërisë dhe për mënyrën si duhet shpëtuar nga këto rreziqe".

Qausere Haxhirexha, pedagoge, foli për aspektin psiko-sociologjik të alkoolit dhe drogës, duke theksuar numrin alarmues në rritje të përdoruesve të alkoolit e drogës, nevojën për një luftë më aktive ndaj kësaj të keqeje për të parandaluar shpërndarësit dhe burimet e furnizimit me drogë. Prindërit, pedagogët dhe shoqëria duhet ta pengojnë këtë rrezik që dëmton gjendjen fizike e shpirtërore të individit, prish gjendjen morale dhe shkakton konflikte në familje".

Dr.Spec. Hekuran Duka, duke folur për



dëmin shëndetësor nga alkooli, droga e duhani dha shpjegime të hollësishme për toksikomaninë, nikotizmin, politoksimaninë dhe narkomaninë. Sipas tij për dhjetë vitet e fundit në Maqedoni janë evidentuar dhjetëra mijëra përdorues të drogës dhe alkoolit që rezulton me sëmundje të vartësisë dhe ndryshime fizike e psikologjike te përdoruesit. Personat e varur nga alkooli dhe droga ndryshojnë pamjen e tyre, regjimin e jetës, pësojnë në sistemin nervor, kardiovaskular, duke dëmtuar enët e gjakut, zemrën dhe mëlçinë e zezë me pasojë cirozën alkoolike. Sipas tij për evitimin e këtyre rreziqeve nevojitet një angazhim në familje, shkollë, mjetet e informimit, institucionet shëndetësore, organizatat humanitare, polici, gjyqësi, institucionet fetare dhe komunale".

Reshat Kaçaniku, teolog, në diskutimin e tij për aspektin shpirtëror nga droga dhe alkooli, theksoi se edhe profeti Muhamed thoshte se është dërguar si mësues për të përforcuar normat e besimit, të moralit dhe mirëqenies. Rinia është krenaria e kombit dhe shoqërisë, ndaj mbështetja e rinisë nuk duhet të jetë te droga dhe alkooli, sepse ato janë nëna e shqetësimeve dhe e zullumeve. Ruani shëndetin para se ta humbni. Kur dhemb një pjesë e trupit lëngon tërë trupi. Droga dhe alkooli janë vepra djallëzore. Njeriu më i dashur është ai që në familje fut gëzim. Të qëndrojmë sa më larg këtyre fenomeneve negative".


Emine Gashi-Rexha, duke folur për drogën dhe alkoolin nga këndvështrimi i prindërit, u shpreh se: "pushteti vendor dhe tërë institucionet duhet ta parandalojnë këtë uragan tepër të dëmshëm për shoqërinë, që vështirëson jetën dhe shkakton strese të paimagjinueshme familjare. Të punojmë më me ngulm në edukimin e fëmijëve tanë në familje dhe shkolla. T'i shtojmë aktivitetet kulturore, artistike dhe sportive të nxënësve dhe rinisë sonë. Të apelojmë dhe veprojmë që kafeteritë të mos punojnë pas mesnate dhe që fëmijët tanë të mos bredhin rrugëve deri në orët e vona".

Arben Dumani, polic, shtoi se: "vartësit e alkoolit dhe drogës janë prishësit kryesorë të rendit dhe qetësisë publike në qytet. Ata nën ndikimin e alkoolit dhe drogës rrezikojnë trafikun, përdorin fyerje, sharje dhe janë konfliktuozë. Droga është e pranishme edhe në qytetin tonë. Drogat të lehta apo të rënda, janë njëlloj vrasëse sikundër armët e lehta apo të rënda. Përdoruesit e drogës janë shkatarë edhe të vjedhjeve që bëhen në qytet për të ardhur te paratë për të blerë drogë. Ne si polici veprojmë sipas planeve tona operative për të ndjekur e luftuar kontrabandën dhe përdorimin e drogës", tha në fund Arben Dumani.

R.TORTE

gjuha

Prof. Dr. Hajri Shehu sjell një studim praktik për mjetet e informimit të publikut, mbi standardet e gjuhës së shkruar dhe të folur shqipe. Të gjithë shembujt e dhënë në shkrimin e mëposhtëm janë marrë nga televizionet, radiot e gazetat e Tiranës.



Nga:
Prof. dr. Hajri SHEHU

Për **pastërtinë e gjuhës** së mjeteve të sotme të **informimit masiv**



> Përdorimi pa vend i fjalës së huaj e burokratizon gjuhën e shtypit, të televizioneve e të radiove. Në përmasa të ndryshme, këtë soj burokratizimi e sheh në mjetet tona të informimit masiv

(Vijon nga numri i kaluar)

Përse janë të papranueshme fjalë të tilla të huaja si këto që u përmendën më lart? Janë të papranueshme për disa arsye:

1. Siç dihet, gjuha është një ndërmarrje bashkëpunimi e ortakërie: lexuesi, shikuesi a dëgjuesi është ortak i shkruesit a i folësit. Është e vërtetë se ka një lexues, shikues a dëgjues, përgjithësisht me nivel jo të vogël kulturor, me një fjalor aktiv e pasiv, gjithashtu, jo të vogël, madje, një pjesë, edhe me njohje gjuhësh të huaja. Por ka edhe një lexues që nuk e ka këtë nivel e kur përdoren fjalë të huaja, bashkëpunimi e ortakëria prishen, sepse dëmtohet aftësia kumtuese e shprehëse e thënies, dëmtohet qartësia e kuptueshmëria e saj. Mbase, edhe ata e ato me nivel jo të vogël kulturor nuk do t'i kuptonin të thëna të tilla: *strukturat e bujqësisë do të jenë* **agresive…;** *kopje libri* **të dekoruara** *me ar; monedhat janë* **konservuar**; *do të* **ekzekutojë** *projektin; dosje që janë* **ekzekutuar**; *çështja do të ketë një* **solucion; divizioni** *i energjisë elektrike…; konkurrencë e* **konkordancave;** *në* **substancë** (për *në thelb*); *për* **indeksin** e **performancës** *...; mos na* **presoni** *se jemi të* **presuar** etj.

2. Ndër fjalët e shenjuara stilistikisht në faqet e gazetave (kryesisht në kryeartikuj, në artikuj publicistikë etj.), më së pari, janë ato librore. Fjala e huaj, siç dihet, tingëllon domosdo librore në krahasim me fjalën shqipe. Pra, jo vetëm, thjesht si të huaja, por si librore, ato e rëndojnë gjuhën dhe vetë mjetin e informimit masiv.

3. Natyrisht, gazetat, televizioni e radioja, si mjete të informimit masiv, kanë edhe shkrime e emisione me rreze të gjerë, nga të gjitha fushat e jetës, pra, edhe shkencore, teknike, fetare etj. Ndërkaq, lexuesit, shikuesit e dëgjuesit u përkasin grupeve të ndryshme sipas shkollimit, profesionit etj. dhe i duan të tilla shkrime e emisione. Kjo do të thotë që nuk mund të mos ketë shkrime e emisione që u përkasin rretheve të tilla lexuesish, shikuesish e dëgjuesish; kjo do të thotë, atëherë që nuk mund të mos intelektualizohet gjuha e shkrimit a e emisionit e nuk mund të mos përdoren terma; pra, nuk mund të mos ketë në këto shkrime e emisione vlera të domosdoshme gjuhësore, që pasqyrojnë zhvillimin e kulturës botërore e që gjuha i ka bërë të vetat për arsye gjuhësore e jashtëgjuhësore (ndërkombëtarizma - fjalë ndërkombëtare, huazime të vjetra greke, huazime latine, angleze, italiane etj., të tilla, si *blister (bakër blister), buxhet, çek, telefaks, teletekst, skaner, klonim, kultivar (*nga *cultivated variety), olimpiadë, laburist, lord, rokenroll* etj.). Këtu, sigurisht ortakëria e thjeshtësia mund të mos jenë të kënaqshme. Por ajo që është për t'u qortuar në mjetet tona të informimit masiv është: a) Përdoren fjalë të huaja të panevojshme, jo vetëm në tekste *shumë të veçanta* (që gjithsesi, të tilla tekste nuk duhet të kenë vend aty sepse shtypi, televizioni, radioja nuk janë tubime specialistësh, financierësh, mjekësh etj.), por edhe në tekste me karakter shkencor-popullarizues (shih, p.sh. si flitet në një emision për drogat: *vetitë psikotrope* (të kanabisit); *si kreativ klasifikohet si drogë; produktet e derivuara të kanabisit; kanabis tranzitohej ...; aplikoi politikë ...* etj. etj.) e edhe më keq, edhe në shkrime, emisione etj. të zakonshme (shih, p.sh.: skuqja e fytyrës që themi se zgjat pesë orë, quhet *flashing; data* materiale; kutia do të hapet *laiv*, me veshjet e *dezinjuara*; situata *hidrike;* këmba *e amputuar; panel (panel* specialistësh etj.); *kampus (kampus* universitar*);* park publik *linear; gjeneratë* e anijeve kozmike*;* qumësht *i kontaminuar;* Shqipëria nuk është vend *i intoksikuar;* erdhi nga një *penalizim* (është fjala për garat automobilistike); nuk e *rikuperon* rezultatin; jetojmë në këtë botë *kompetitive*; etj.), madje, edhe në reklama (shih, p.sh. në një reklamë televizive: *në kohë reale...; rregullojnë metabolizmin; sistemin tonë imunitar; sistemi kardiovaskular ...* etj. etj.). b) Nuk kërkohen fjalë të analizueshme nga pikëpamja kuptimore e fjalëformuese, domethënë, nuk kërkohen fjalë shqipe, formime shqipe a edhe huazime *të përkthyera* nga ndonjë gjuhë e huaj (gjuhësisht: kalke). Një shembull. Kohë më parë, për ndërtesat shumëkatëshe në Amerikë u përdor fjala *billding*, madje bënë edhe shumësin *billdingje;* kurse në një emision për Tokion u përdor fjala italiane *grataç(i)elë*, e cila është vetë përkthim nga anglishtja. Por, sipas gjedhes popullore, në shqipe ka një formim shumë të këndshëm – *rrokaqiell (*si formimi popullor *djegagur*), me ndërtim të brendshëm që përputhet me nocionin "ndërtesë aq e lartë sa rrok qiellin" e me shprehësi më të madhe edhe se përkthimi (kalku) i dikurshëm *qiellgërvishtës* a *qiellgërryes.* Por, pikërisht te ndërtimi i brendshëm e te shprehësia është edhe një nga vlerat e fjalës vendëse ose e formimit vendës dhe një ndër mundësitë për ta përzënë fjalën e huaj të panevojshme. c) Nuk ruhen lidhjet me gjuhën e gjallë të popullit e nuk shfrytëzohet gjuha e popullit. Përfundimi: jemi në udhë të kundërt me demokratizimin e mëtejshëm të gjuhës së gazetës, të televizionit a të radios.

4. Përdorimi pa vend i fjalës së huaj e burokratizon gjuhën e shtypit, të televizioneve e të radiove. Në përmasa të ndryshme, këtë soj burokratizimi e sheh në mjetet tona të informimit masiv. Fjalë të huaja, të marra drejtpërdrejt a të përkthyera drejtpërdrejt (të kalkuara) keq nga gjuhët e huaja, kryesisht nga anglishtja janë bërë simbol e stil të kumtuari e janë kthyer gatigati në zhargon (shih *staf* e *draft, impakt* e *implementim, efiçensë* e *bekgraund, shou* e *emergjencë, kompeticion* e *prioritet, asistoj* e *inicioj, lider* e *lidership, risk* e *resurs, startoj* e *monitoroj, kolaps* e *akses, opsion* e *handikap, suport* e *suportoj, supervizoj* e *investigoj, prononcim* e *kontestim, performoj* e *performancë, axhendë* e *evazion fiskal***,** *në respekt* / të ligjit e *në akordancë (në akordancë të plotë me faktorin ndërkombëtar*) etj. Jo rrallë, ato dëshmojnë jo vetëm për thënie stereotipe, por edhe për keqkuptime e gabime në shprehjen e mendimeve; shih, p.sh.: pasi u *instalua* qeveria e re / u *instaluan* policë rreth ambasadës*;* muzikë e *masterizuar; shërbim inteligjent* / për *"shërbim zbulimi"* ose "*shërbim i fshehtë"*; policia veproi sipas *inteligjencës*; me *potencial* të madh për aksidente; të *procedojmë* me një politikë të re; *operojnë* jashtë ligjit; ajo që duhet *ekzekutuar* në këtë çast; polici *kriminale;* shndërrim *aksidental;* opozitë *aksidentale*; politikë *aksidentale*; ju keni zgjedhur *aksidentet*; për *promovimin* e grave në zgjedhje; të gjithë vijnë nga jurisprudenca dhe *implementohen* në sektorë që nuk kanë lidhje me jurisprudencën; në këtë *panel* do të jetë *akomoduar* juria jonë / vini re: njerëzit zgjedhin *aksidentet*, gratë *promovohen* si librat, *instalohen* policë, siç instalohen në një ndërtesë pajisjet hidraulike, *implementohen* njerëzit, siç implementohet një marrëveshje a premtim, *akomodohen* njerëz në *panel*, por *akomodimi* lidhet edhe me hotele e me fjetje (!) etj.

Vërtet, shqipja është gjuhë e hapur e dinamike dhe ka aftësinë t'i rindërtojë fjalët e huaja për nga shqiptimi, shkrimi e ndërtimi gramatikor, por kjo nuk na jep kurrsesi të drejtë të fusim pa të keq në shkrimet e në kumtimet tona barbarizma, fjalë të marra kallëp nga gjuha e huaj. Shih, p.sh., si merret pa farë ngurrimi folja e huaj, rindërtohet me një – *o/j* dhe dëgjuesi e lexuesi ndritet me kryqëzime a hibride të tilla të neveritshme: *agravoj, akomodoj, alinjoj, alokoj, anunçoj, çekoj, çertifikoj, definoj, dekonfliktoj, dipendoj, diversifikoj, elaboroj, embarkoj, eskaloj, evadoj, finalizoj, gjeneralizoj, gjeneroj, impostoj, impotentoj, induktoj, inicioj, interferoj, investigoj, involvoj, komportoj, kondicionoj, konkordoj, konstituoj, kontestoj, multiplikatoj, nominoj, performoj, persistoj, prevenoj, prezumoj, relaksoj, selektoj, startoj, supervizoj, suportoj, surprizoj* etj. Po se mos vetëm folje?! Me një *–isht* pas, edhe ndajfolje *(civilisht, nominalisht, probabilisht* etj.). I nderuar lexues, ka edhe kryqëzime të tjera "më të bukura". Pse, a nuk është më i bukur *multigrindje*?!Ku shkon kumtimi a shkrimi ynë? Për kë flasim e për kë shkruajmë? A na kuptojnë, vallë të tjerët kur shkruajmë a kur flasim kështu: *20000 euro konvertib(i)le ..., në shtatë lokacione; në instancë të parë...; në prag të falimentit; frustrimet kanë ardhur ...; eveniment universal... llaiv; do të vijnë për të performuar; opozita kthen në fokusin e saj; pas samitit ...; sensi i gjyqtarëve; penalizim për gjyqtarët; të startojnë sezonin pa sponsor; lobingjet...; impenjimi i futbollistëve; administrata rekruton punonjës të rinj* etj. Ku shkojmë kështu ?! A nuk është thyerje subjektive e standardit ?!*

Atëherë, që **subjektivisht,** të mos hapet shtegu për të depërtuar fjalë të huaja të panevojshme në mjetet tona të informimit masiv, a mund të biem në një mendje e të vendosim një kriter themelor për pranimin ose për mospranimin e tyre? Kriteri mund të ishte **vlera** e fjalës së huaj në gjuhën shqipe standarde. Sipas këtij kriteri, në qoftë se fjalët e huaja nuk sjellin vlera të reja - nuk shënojnë sende, nocione, koncepte e dukuri të reja, nuk kanë ngjyresa të reja kuptimore ose shprehëse – emocionuese e stilistikore për gjuhën shqipe standarde, nuk ka pse të pranohen. Përse? Sepse janë thjesht dysorë (dublete) të fjalëve shqipe. Duke qenë dysorë, ato nuk sjellin as rritje sasiore të fjalorit (leksikut) të shqipes, domethënë nuk zënë dot qeliza të tij të zbrazëta e aq më pak, nuk sjellin ndonjë ndikim cilësor në të. Krahaso, p.sh., *lider* e *lidership.* Në të kaluarën, këto njësi e të tjera si këto, me përmbajtje politiko-shoqërore shënonin ndryshime të karakterit ideologjik, politik e shoqëror dhe si ideologjizma e politicizma, nuk mund të kishin të njëjtin ngjyrim, domethënë, nuk përputheshin ngjyrimet vlerësuese-emocionuese midis fjalës angleze në anglishte dhe fjalës angleze në shqipe. Në anglishte të tilla njësi janë asnjanëse; në shqipen kishin ngjyresë mospëlqimi; krahaso thëniet: *liderët perëndimorë …*, por *udhëheqësit e Partisë dhe të shtetit…* Sot, këto fjalë nuk e kanë këtë ngjyrim, sot kanë mbërritur në kuptimin fillestar që kanë në gjuhën angleze, domethënë, ato dalin tërësisht si dysorë krejt të panevojshëm të fjalëve shqipe *udhëheqës* e *udhëheqje* e prandaj përdorimi i tyre në mjetet e informimit masiv është i gabuar.

A mund të quhet purizëm përpjekja për të mos pranuar fjalë të huaja të panevojshme ose për t'i zëvendësuar ato me fjalë a me formime shqipe?

Jemi të bindur se nuk mund të ketë në rrethet tona mediatike ndonjë mendim që e barabit kërkesën për të mos përdorur fjalë të huaja të panevojshme me purizëm, kur siç dihet, lufta për pastërtinë e shqipes ka qenë e është edhe vetë historia e qenia e saj. Sidoqoftë, le të përgjigjemi shkurt.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Rruga Arbërit nr. 31
kritikë

Ilir Spata është një poet i lindur që poezinë e ka mbajtur në gjirin e vetë si Këngë të pakëndueme për shumë e shumë vjet dhe sot ajo shpaloset e bukur, e sinqertë, me plot figura artistike, disa mjaft brilante

Poetika e legjendës

Rreth librit ***Legjenda e një fisi*** të Ilir Spatës

Nga: XHAFER MARTINI

PROFIL I RI I ILIR SPATËS

Deri më tani Ilir Spatën e kemi njohur si nxënës të shkëlqyer të tri kategorive të shkollave (fillore, shtatëvjeçare dhe gjimnaz), që pati mundësi të mbaronte në kohën e diktaturës; si një sfidues i saj nëpërmjet bejteve që krijonte në përbërjen e grupit artistik të kooperativës bujqësore te Fushë Çidhnës, si ish – i burgosur politik, si një aktivist i shquar dhe lider lokal i Partisë Demokratike dhe si një drejtues i suksesshëm i pushtetit vendor.

Ka vite që Iliri jeton familjarisht në SHBA. Në librin tim **Pedagogjikasit**, botuar dy muaj më parë, bëja edhe portretin e Ilir Spatës, si një nga ish-nxënësit më të shkëlqyer që kisha mësuar në jetën time si mësues. Këtë portret unë e quaja të *përfunduar,* në kuptimin që nuk mund të thoshja më gjë për Ilirin. Po ja ku ai na *detyron* të merremi prapë me të, duke e parë në një këndvështrim tjetër, në atë të poetit, përderisa kemi në duar librin e tij poetik **Legjenda e një fisi**, botuar nga shtëpia botuese "M&B", dhe nxjerrë në qarkullim kohët e fundit. E mora me kërshëri të madhe këtë libër, por edhe me një farë mosbesimi të lehtë, se kisha frikë që Iliri tashmë kishte hyrë *në një livadh* të huaj. Shkurt, kujtova se edhe atë e kishte përfshirë *sëmundja* e shumë të tjerëve që duan patjetër të botojnë të paktën një libër, edhe kur nuk kanë talent për një fushë si ajo e letrave. Talenti, kur nuk e ke të lindur, nuk blihet as me ar, prandaj as kultura, as puna, as dëshira e madhe nuk japin rezultat. Duke u nisur nga sa thashë, më vinte keq që dashamiri im Ilir Spata të lodhej dhe të përpiqej kot. Por Iliri, për fat të mirë, na shfaqet si poet i vërtetë. Le ta shikojmë në këtë profil.

LEGJENDA DHE HISTORIA

Legjenda e një fisi, për nga lloji letrar, është një poemë shumë e gjatë, mbështetur tek një legjendë që në Dibër, mbase edhe më larg saj, njihet mirë. Është fjala për një nga fisi Lusha në Arras të Dibrës së Poshtme që, në krye të krushqve të zgjedhur, shkoi dhe i mori vashën e fejuar vezirit të Shkodrës. Ka nevojë për pak shpjegim. Sipas legjendës, Hoxholli i Dibrës, që në veprën e sipërpërmendur cilësohet Pasha, ka fejuar djalin me një vashë të vezirit të Shkodrës. Për arsye nga më të ndryshmet, ku më kryesoret ishin arsyet politike dhe rivaliteti ndërkrahinor dhe krahinor, veziri nuk ia jep vashën e fejuar Hoxhollit. Kur i shkojnë krushqit e parë, ai u pret atyre nga një palë petka të reja dhe i përcjell pa nuse. Hoxholli dërgon krushqit e dytë, të zgjedhur nga shtëpitë më të mira të Dibrës së Epër, të cilët besonte se nuk do t'i vinin pa nuse. Por edhe ata, ashtu si edhe të parët, u kthyen me petka të reja, pa nuse. Hoxholli detyrohet të bjerë në Dibër të Poshtme, tek Lusha, që të shkojë për t'i marrë nusen. Lusha shkon, pranoi detyrën e ngarkuar, por jo për t'i bërë nder Hoxhollit, ose pse u ble prej tij. Hoxholli dhe veziri gradat dhe privilegjet i kishin fituar prej Turqisë. Për çidhnakët, parë nga ky prizëm, ata janë të njëjtë. Por ka edhe një nder krahinor, që është i Nëntë Maleve të Dibrës, dhe këtë nder shkojnë për të vënë në vend Lusha dhe çidhnakët. Kjo është legjenda.

Legjenda mund të jetë pjesë e historisë, ose, si të themi, një histori e muzguar, e pashkruar, që, duke kaluar vite e shekuj, duke mos u dokumentuar, kalon më parahistori dhe mjegullohet fare. Pra, kthehet në një legjendë. Por ajo mund të jetë vetëm një sajesë e njerëzve, të cilët, me kalimin e viteve, zmadhojnë dhe glorifikojnë ngjarje dhe personalitete, duke u dhënë atyre dimensione dhe cilësi të paqena.

Ilir Spata mbështetet mbi legjendën për të krijuar poemën e tij, jo mbi historinë. Ai krijon një vepër letrare, pa mundësi reference historike, ndonëse, si ka thënë një dijetar, legjenda nganjëherë është më e vërtetë se historia. Pra, me pak fjalë, poema e Ilir Spatës është poetizimi i një legjende. Për këtë arsye autori, duke i dalë përpara çdo keqkuptimi, shkruan në hyrje të librit se "Asnjë ngjarje apo personazh në këtë poemë nuk duhet të merren për referencë historike. Pavarësisht mbështetjes në ngjarje dhe gojëdhëna historike, si dhe në traditën folklorike të vendit, ajo është një krijim artistik."

REALIZIMI ARTISTIK

Por, pavarësisht nëse poeti mbështetet mbi një ngjarje të vërtetë ose mbi një legjendë, kur gjykojmë si krijim artistik (dhe kështu do të gjykojmë), shikohet realizimi artistik, a është vepër e arrirë, a ka cilësi artistike, apo është një vargëzim i thjeshtë. Këto shikohen, dhe jo vërtetësia e ngjarjeve.

Por, para se të shkojmë tek ky problem kyç, ashtu si e kam kuptuar unë, nocioni **fis,** në këtë poemë është shumë më i gjerë se sa një fis i caktuar, qoftë ky edhe fisi i Lushë Çidhnakut, që është heroi kryesor i kësaj poeme. Pra, përveç fisit të Lushë Çidhnakut, kuptojmë edhe fisin e Çidhnës, Malin e saj, dhe më tej: poema na krijon hapësira që të kuptojmë me fjalën **fis** edhe Nëntë Malet e Dibrës. Madje unë do të thosha se fjala **fis** në këtë poemë përdoret edhe në kuptimin e racës shqiptare, fisit shqiptar, cili paraqitet me ato veti dhe karakteristika që shprehin më mirë identitetin tonë kombëtar, si janë: besa, mikpritja, nderi kombëtar, krenaria kombëtare, gjuha, traditat, kultura, mënyra e jetesës, etj. Këtë mendim që po shfaqi, pra, për krijimin e një hapësire më të madhe për fjalën **fis**, na e imponon vetë poeti te këngа e parë e poemës që titullohet : **Në vendin tim mos trazo gurët**, e cila është jo vetëm me përmbajtje të thellë, por edhe me vlera të spikatura artistike. Kjo këngë është më prezantuesja për poezinë e Ilir Spatës si lloj vargu dhe, sidomos për realizimin artistik. Po citojmë pak vargje:

"Në vendin tim
Mos trazo gurët!
Lisat e moçëm
Mos i gërgat!
Se britma dhimbjeje
Do lëshojnë muret
Rrënjët e degët
Do kullojnë gjak.
Në vendin tim
Mos prek muranat
Se malet shemben
E të mbulojnë!
Telave të shpirtit
Mos trazo nanat
Se detet thahen,
Lumenjtë shterojnë!"

Për nga vargu, si shikohet, është një dhjetërrokësh i thyer, që është tamam varg popullor, por i rrallë dhe i vështirë në përdorim. Me këtë varg pothuaj është shkruar krejt poema, megjithëse poeti herë- herë, për nevoja artistike, por edhe për të mos e lodhur lexuesin, kalon në vargje dhe strofa të tjera. Meqë jemi tek ky problem, duhet thënë se Ilir Spata si poet ka një larmi ritmike, larmi vargjesh, rimash dhe asonanacash, çka e bën poetin të përballojë një krijim aq të gjatë, si është kjo poemë.

Për mendimin tim legjenda në fjalë, vetëm i ka shërbyer si pikënisje poetit për të krijuar hapësira dashurie për kombin shqiptar. Këto ndjenja dhe mendime që i kanë vëluar në zemër prej shumë e shumë vitesh, ai i thotë në moshën 50 - vjeçare. Është nga të paktët poetë që ka pritur që fjala të bëhet e lirë. Më shumë se sa fati i një krushqie, poetin Ilir Spata në këtë poemë e preokupon fati i kombit shqiptar; ai është i trazuar shpirtërisht dhe i helmatisur në zemër se si të gjitha të këqijat i kanë rënë në kokë pikërisht kombit që ai i përket. Duke mos u distancuar asnjë grimë prej tij, por, përkundrazi, duke u shkrirë në çdo qelizë me të, poeti rreket të tregojë se nga i ka ardhur ky mallkim këtij kombi që gjatë gjithë historisë vetëm ka vuajtur. Mos vallë ky është një mallkim hyjnor? Mos vallë ky komb e ka të keqen brenda vetes së tij, nga që djemtë e vetë nuk janë të zotët ta nxjerrin nga baltovina ku ka rënë dhe ta shpien në rrugët e progresit historik? Ja, këto pyetje e shumë të tjera si këto, e shqetësojnë poetin. Ky shqetësim del sidomos tek këngа **E parathëna** (mallkimi), ku ka vargje mjaft të bukur si këto:

"S'u gjend një djalë
S'doli një burrë,
Të zgjojë nga gjumi
Shpirtin e lashtë.
Mbi Lumë të Zi
Të hedhë një urë
Dheun e Maleve
Ta bëjë bashkë?!
Nëma e vjetër
i mbajti veças
S'i la t'mblidheshin
T'bëheshin tog.
Ngelën pas botës
Viteve, shekujve
Ritmin e kohës
S'e ndoqën dot!".

Ajo që në të vërtetë ka lidhje me legjendën, del mjaft vonë në poemë, dhe integrohet mjaft mirë në kohë. Shqipëria, si del qartë në poemë, ndodhet nën pushtimin osman që ngre në këmbë dhe fuqizon me pasuri dhe me ushtri pikërisht shqiptarët si Pasha dhe Veziri për të nënshtruar shqiptarët e tjerë. Ndaj poeti, kur na prezanton për herë të parë se përse grinden pashai më vezirin e madh, ndërron jo vetëm vargun, por edhe qëndrimin artistik, duke shpalosur një humor të hidhur:

"Bota rrotull qesh e tallet,
Një milet po bën sehir.
Një pasha që sundon Malet
Po e tallka një vezir.
Dy herë krushqit i pat nisur
Tek veziri në Veri.
Të dy herët të ujdisur
Prerë e qepur ndër terzi.
Ndër terzi i fut e ndreq
Kokë e këmbë prerë e qep.
"Mirë ardhshi herë tjetër!"
Edhe nusen nuk ua jep.
Tym e mjegull egërsohet
Veten haka një Pasha.
Iku, vate burrëria
Turp e marre kush i mba?"

AKSIONI KONKRET

Aksioni konkret i poemës fillon aty ku pashai mendon se cilin duhet të dërgojë në krye të krushqve për të marrë nusen nga veziri. i tregojnë për një usta, që duk e pamje nuk i kishte dhënë Perëndia, por mendje e trimëri ia kishte dhënë pa masë. Poeti e portretizon shumë bukur, me ca penelata të shkathta heroin kryesor të poemës, Lushë Çidhnakun, i cili është përfaqësues i tërë malësorëve të mençur dhe atdhetarë që kanë bërë shumë për atdheun, por për ta historia hesht, se degët e dafinave kanë qenë për të tjerët, që kanë ditur të përfitojnë nga gjaku i derdhur nga mijëra njerëz të thjeshtë. E pra, ky njeri i zoti, i mençur dhe trim, jepet ashtu si është nga poeti, pa lajle e lule:

"Thekur qe nga hallet
Mendja bërë tel.
E nuhaste ujkun,
Thellë në zabel.
Dovletin e ndjente
Larg si stuhinë.
Sherret s'i kërkonte
Po priste t'i vinë.
Qe komit i regjur
Rritur me t'pa pasë.
Pa i folur mendja,
Nuk ngutej të flasë,
Si gurët e tullat
Vendosur në mur
i venonte fjalët
Në kuvend si burrë.
Zoti, Perëndia
Pamje s'i kish dhënë
Po mendjes e shpirtit
Duart kishte lënë. "

Janë nga më të bukurat ato faqe të poemës ku Pashai bisedon me këtë njeri të popullit. Poeti ka dhënë me vërtetësi botën e brendshme të tyre, pozicionin nga i cili flasin, çështjen që mbrojnë, interesat e cilës shtresë shoqërore përfaqësojnë. Pashai i thotë:

"Ja pse të kam thirrur:
Desha që ta di:
Hyn në gjë për tjetër,
A veç për llaç, mistri?
Më duhet një burrë
Në Male ta kem
Që t'i shkojë fjala
Sikur unë të jem.
Taksa e xhelep
S'paguan njeri.
Mbajtur duhet shteti,
Si t'ja bëj s'e di?
Më duhet dikush
Që t'i bëjë zap,
Herë me marifete,
E herë me dajak."

Por përgjigja e Lushë Çidhnakut është shumë e zgjuar:

"Anës Lumit Zi
Endem fukara.
Tanë ditët e motit
Bredh nëpër dynja.
Gjyshër e stërgjyshër
Një emër më lanë.
Ruej mos e ndyej
Bota më shanë.
Për ca groshë endem
T'i fitoj me mund.
Po e humbe nderin
Nuk e gjen kërkund."

botime

Lloji i poemës narrative, kërkon aftësi kompozicionale dhe Iliri këto i ka shfaqun. Poema ka edhe mjaft pjesë të tjera që jo vetëm nuk shkaktojnë shkapërdredhje kompozi-cionale, por, përkundrazi, japin dorë për kompaktësim të kompozicionit…



Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-19-6
Çmimi: 700 lekë

Poema fiton hapësira të reja kur pashai i thotë që duhet të gjejë njerëz me marrë nusen tek veziri, pasi të dyja palët e krushqve m'i ka kthyer, duke i veshur e i mbathur sikur të ishin leckamanë. Lushë Çidhnaku i thotë:

"Nuk ke rrugë tjetër
Të bëhesh me nder.
Jo me shpurë të vjetër,
Duhen krushq të tjerë."

Kurse pashai:
"Ku t'i gjejë krushqit
Që të jenë tamam,
Të më sjellin nusen
E nderin që kam?
Të mos shkojn' e vijnë
Mbushur edhe ngjeshë,
Me rroba te reja
Veziri t'i veshë?"

Kurse Lushë Çidhnaku i thotë:
"O pasha i naltë,
fajin e ke vetë,
se malet e fushat
i shkretove krejt.
Në litar e plumb
Çove djelmninë
T'i kishe tani
Tmerronin vezir'n.
Mbrapa po t'i kishe
Gjithë ata që qenë
Nami dhe zani
T'kishte marrë dhenë".

Por, në fund, për arsyet që i thamë në fillim, pasi "**Vihet në lojë/ nderi i Dheut**" Lush Çidhnaku merr përsipër t'ja sjellë nusen në derë pashait. Në këtë pikë poema merr një hapësirë të re, pasi në të shkrihen edhe legjenda të tjera, si për shembull, ajo e ngritjes së vëllait nga varri, por që këtu ka marrë një trajtim të ri, pasi akti i ngritjes nuk bëhet për motive personale, por atdhetare. Kjo del në këngën **Vegimi,** që është nga më të bukurat për nga niveli artistik. Poema në tërësi fiton një konfiguracion të ri, pasi del nga shtrati i zakonshëm, dhe pasurohet me elementë të mrekullishëm si janë: udhëtimet e të vdekurve me të gjallët, ringjalljet, shfaqja e zanave dhe kreshnikëve , shkurt një pasuri e tërë mitologjike, si ajo që është edhe në eposin tonë të kreshnikëve.

Nisja e krushqve është vërtet madhështore, dhënë me vargje të spikatura që do t'i kishte zili çdo poet i mirë:

"Vargan i gjatë
Tretet me dritën.
Kuajve këmbët
S'u zënë dhè,
Në vend të tagjisë
Përtypin yje,
Në vend të barit,
Bashka me re.

Mbi kreshta, maleve
Jelet e bardha
Era i tund
Si det me valë
Tek turijtë shfryjnë,
E turfullojnë
Mbushen luginat
Me mjegull t'bardhë."

Ndeshja me vezirin, ndeshje shpirtërore, se nuk u bë me pushkë, do të zhvillohet në Shkodër. Poeti nuk ka dashur që dikush që nuk mendon shumë, të konfondojë Shkodrën me vezirin. Prandaj një nga këngët më të mrekullueshme është ajo kushtuar Shkodrës, historisë dhe kulturës së sajë, që poeti i evidenton me figurat më brilante.

Lushë Çidhnaku edhe me vezirin tregohet i matur se është prej atyre trimave që nuk e kërkon sherrin, por nuk i trembet kur ia ndezin të tjerët. Shprehet qartë dhe pa mendjemadhësi, si burrë malësie:

"Të fala me shëndet
Ke prej Pashait.
Një amanet
Kem ardhë me marrë.
Si miku-mikut
Si vllau-vllait
Rrugën ta marrim
Drita pa zbardhë".

Me gjithë këtë, veziri kujton se këta krushq me Lushë Çidhnakun në krye, janë si ata të parët, prandaj, sipas tij, nuk ka përse të sillet ndryshe:

"Zakoni, sëra
Ma do respektin,
Krushqit t'i presë
E t'i gatit.
Rrobat ma t'mira
Urdhër t'i presin
Me kohë kanë marrë
Të gjithë terzijtë."

Por Lushë Çidhnaku i përgjigjet ashpër në përmbajtje, por ulët me ton:

"S'e kem marrë rrugën
Për tirq, koprane.
Nusen ne duem,
se jemi krushq.
E sa për rroba,
Ndera t'u rritët
Të gjithë i kemi
Palosun në dujq."

Por veziri edhe pse nuk ka kuptuar se me kë ka të bëjë, dërgon njerëzit e vetë për të shikuar se ç'rroba kanë krushqit në dujq. i raporton njeriu më i afërt, që e ka edhe këshilltar:

"Vezir i ndritshëm,
Ymër dhe jetë
Të dhëntë Zoti
Ndën Padishah!
Qefinë të bardhë
Vdekjen vetë,
Kanë marrë me vete
Mbi kuaj të bardhë."

Pasi merr këtë njoftim, veziri e ndërron pllakën dhe vendosë t'ua japë nusen këtyre krushqve mendjendarë, që kanë udhëtuar me vdekjen. Vendosë t'u bëjë edhe dhurata, jo fyese, duke i veshur dhe i mbathur, por prej atyre që japin miqtë e pasur për miqtë e varfër. Veziri do me çdo kusht të bëjë për vete Lushë Çidhnakun, se mendon që ai ndonjë ditë mund t'i duhet, prandaj i thotë:

"E shohë: skamja
Të ka mbulue.
Gjezdis njerëzinë
Për pak para.
Po ta dinte
Nahija jote
Se sa mend ke
S'të linte usta."

Por Lushë Çidhnaku i përgjigjet ndryshe:

"Vezir i naltë,
Ty t'u shtoftë ndera.
Për vete s'due
Besa një groshë.
Jam derë sojlie
E ma do sëra
Ta ruaj nderin
Me xhepat bosh.
Po ti në don
Emri të t'mbetet
Vepër që s'shuhet
Në Histori,
Na ndih me pare
Të ngremë një urë
Ku mblidhet, tkurret
Lumi i Zi".

Dhe veziri:
"E thanë, e bame,
Ja kthen veziri.
Eh, burrë i dheut
Ç'asht ajo fjalë?!
Ti bashqitap
Gatit e nxiri
Dy palë dujq
N'ma t'mirin kalë
Flori safi
Urën ta ngrenë
Gati të jenë
Drita pa dalë."

Lushë Çidhnaku kthehet jo vetëm me nuse në Dibër, por edhe me dujqit me flori me të cilin ndërtoi urën. Nuk i mbet urës emri i vezirit, por i Lushës, që e ka edhe sot: Ura e Lushës.

DISA PËRFUNDIME

Përfundimet jepen në fund të studimeve shkencore. Unë bëra vetëm një vështrim panoramik dhe jo të thelluar të poemës së Ilir Spatës **Legjenda e një fisi,** duke iu përgjigjur kështu dëshirës së lexuesve të shumtë të gazetës *Rruga e Arbërit***.** Me gjithë këtë, edhe me këtë mënyrë vështrimi në disa përfundime mund të arrihet.

Për mendimin tim, Ilir Spata është një poet i lindur që poezinë e ka mbajtur në gjirin e vetë si *Këngë të pakëndueme* për shumë e shumë vjet dhe sot ajo shpaloset e bukur, e sinqertë, me plot figura artistike, disa mjaft brilante.

Lloji i poemës narrative, ose me subjekt, kërkon aftësi kompozicionale dhe Iliri këto i ka shfaqun. Përveç boshtit kryesor - marrja e nuses nga Lushë Çidhnaku- poema ka edhe mjaft pjesë të tjera që jo vetëm nuk shkaktojnë shkapërdredhje kompozicionale, por, përkundrazi, japin dorë për kompaktësim të kompozicionit, pasi pasurojnë veprën duke i dhënë asaj një frymëmarrje më të gjerë, sidomos në aspektin e paraqitjes lirike të jetës. Ky ka qenë, me sa duket, edhe pikësynimi i autorit, i cili nuk ka dashur të jetë një narrator i rëndomtë dhe i mërzitshëm. Kështu, si shembull, kemi përshkrime të shkëlqyera të natyrës, jepen me mjeshtëri portrete të luftëtarëve, nënave, vashave, zanave, hyjnive, etj, etj. Poema është, pra, sa epike aq edhe lirike.

Poema e Ilir Spatës ka edhe pjesë të zgjatura dhe të stërzgjatura, vargje pa nerv dhe vargëzime, por këto janë të meta të të gjitha krijimeve të gjata. Me të drejtë është thënë *se edhe Homerin e madh nga njëherë e zinte gjumi*.

Poema ka edhe ndonjë këngë të tepërt që nuk është funksionale në asnjë këndvështrim që ta shikosh, si për shembull, *Kanga e rapsodit*. Këto, megjithatë, janë punë redaktoriale.

Në tërësinë e vetë poema qëndron. Dhe qëndron me dinjitet.

Kërkojeni librin tuaj në tel. 04 22 33 283 ose shkruani në email. mbbotime@gmail.com

Janë në qarkullim nga shtëpia botuese "M&B"



Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-19-6
Çmimi: 700 lekë

Mund ti porosisni
me tel:
+ 355 4 2 233 283





Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-14-1
Çmimi: 500 lekë

Mund ti porosisni
me email:
mbbotime@gmail.com



Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-12-7
Çmimi: 1000 lekë

Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-13-4
Çmimi: 1200 lekë

Hoxhë Buci është dekoruar me medaljen "Për veprimtari patriotike". Një vlerësim do të ishte në nderin e institucioneve tona demokratike në këtë 95 vjetorin e rënies së Bajram Bucit dhe djalit të tij Mustafait.

Hoxhë Buci i Katërgrykëve



Nga:
MOISI MURRA

Hoxhë Bajram Buci lindi në Lukan të komunës së Selishtës rreth viteve 1835-1840. Mësimet e para dhe të mesme i mori në medresën e Shkupit ku veç gjuhëve orientale mësoi dhe atë sllave [1]. Arsimimi në këtë medrese, siç duket, është bërë nga Iljas Pashë Dibra. I ati i Bajramit, Daliu, kishte luftuar përkrah Iljas Pashës e burrave të tjerë dibranë në mbrojtje të trojeve shqiptare kundër sllavëve në Mal të Zi dhe grekëve në Thesali.

Kjo shkallë njohje padyshim që ka ndikuar që Iljas Pasha të kujdeset për arsimimin e Bajramit. Studimet e larta Bajram Buci i vazhdoi në Stamboll ku mori dhe titullin molla, si shprehje e njerëzve të ditur. [2]

Pas kthimit nga Stambolli Hoxhë Buci shumë shpejt bëri zë jo vetëm si klerik, por dhe si një veprimtar me peshë në të mirë të çështjes kombëtare. Në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 1860-1870, kur Hoxha nuk ishte më shumë se 25 vjeç, së bashku me Sul Koneshën e Mer Kolecin, luajtën një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ndjesive kombëtare të katërgrykasve. [3] Ndër kohë personalitetet më të qënësishëm të kombit shqiptar ishin përfshirë në një lëvizje që dalëngadalë po konturohej në një organizëm mbarëkombëtarë që u kurorëzua me themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me 10 qershor 1878. Ndër përfaqësuesit e kësaj lëvizjeje në Dibër, ka peshën e vet të padiskutueshme edhe Hoxhë Buci. Ai që në vitin 1870 kishte arritur të afronte dhe të organizonte një çetë kryengritëse në Katërgrykët e që veprimet e saja i lidhi me ato të Hasan Kacit e Halil Menës në Lurë të Najram Dodës në Reç. [4]

Si njeri i mësuar, si shqiptar, si atdhetar Hoxhë Buci, qe i pranishëm në të gjitha ngjarjet e mëdha që kaloi Shqipëria në 30 vitet e fundit të shekullit XIX dhe 10 vitet e para të shekullit XX. Ai u vu përkrah Iljas Pashë Dibrës dhe mori pjesë gjallërisht në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Tetë ditë pas themelimit të Lidhjes, përbri gjithë përfaqësuesve të viseve shqiptare, hedh firmën dhe Hoxhë Buci në "Urdhëresën e Lidhjes Shqiptare për organizimin e administratës dhe të ushtrisë së saj të veçantë".[5] Që nga ky çast dhe deri kur Lidhja Shqiptare e Prizrenit pushon funksionet e saja, Hoxhë Buci qëndroi pranë Iljas Pashë Dibrës si sekretar i tij. [6]

Nga mesi i shkurtit të vitit 1881, ideologu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashëri, vjen në qytetin e Dibrës së Madhe ku i bëhet një pritje me të vërtetë madhështore nga dibranët. Elementet prosulltanist që nuk i shihnin me sy të mirë lëvizjet shqiptare për shkëputjen nga Turqia Osmane i organizojnë atentat Abdyl Frashërit që për fat të mirë përfundoi vetëm në plagosjen e kalit të tij. [7] Abdyl Frashëri pasi fali atentatorin e i qetësoi dibranët e tensionuar për këtë ngjarje, vazhdoi udhën drejt jugut të Shqipërisë. Nga qyteti i Dibrës së Madhe ndoqi udhën e Salistës. Një natë bujti në konakun e Has Bajramit në Kacni. Të nesërmen u përcoll nën sigurinë e katërgrykasve me Hoxhë Bucin në krye për në Qafë-Murrë e prej aty në Mat e Tiranë.[8]

Pas shuarjes së veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Haxhi Zeka ngriti dhe një herë flamurin e Lidhjes në Pejë, në janar të vitit 1899. Nën frymën e Kuvendit të Pejës u mbajt dhe ai i Dibrës, me 27 shkurt të po atij viti. Kuvendi i Dibrës nxori qeverinë për Sanxhakun e Dibrës me president Salim Rusin e Dibrës së Madhe. Midis 31 delegatëve të Sanxhakut të Dibrës është i pranishëm edhe Hoxhë Buci. Në dokument është shënuar bajram Dule. [9] Këtu ka mundësi të kemi një shtrembërim të emrit Daliu, babait të Bajramit, në Dule.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë nga pushtimi i gjatë osman, Dibra ra nën pushtimin e egër serb. Ëndrrat e dibranëve, përpjekjet e tyre shekullore për të qëndruar të lirë e të pavarur në trojet e tyre sikur u fashitën. Sjelljet e serbëve në Dibër u bënë me të vërtetë të padurueshme: vrasje, varje, mbytje, djegie, përdhunime e vjedhje. Këta veprime çnjerëzore bënë që me 21 shtator 1913, në Dibër të shpërthente kryengritja më e madhe në atë kohë kundër serbëve.

Udhëheqësit e kryengritësve popullorë, Elez Isufi, Mersim Dema, Selman Alia, Bajram Buci, Sefedin Pustina, Halil e Haxhi Kaloshi, Dan Cami, Hasan Koçi, Ramadan Kanxha, Qazim Lika, organizuan dhe nisën sulmin në tri drejtime kundër trupave serbe të përqendruara në të gjithë Dibrën. Në drejtimin Dibër e Poshtme – Kala e Dodës – Lumë – Prizren sulmuan trupat e përbashkëta dibranë e lumjane të udhëhequra nga Elez Isufi, Selman Alia, Halil Kaloshi sulmuan boshtin kryesor të përqendrimit të trupave serbe me bazë nisje Dibër e Poshtme – Peshkopi – Maqëllarë, Dibër e Madhe. Në krahun e djathtë Selishte – Homesh – Gollobordë, Strugë, Malet e Petrinos sulmuan kryengritësit dibranë të udhëhequr nga Bajram Buci, Mersim Dema, Dan Cani, Hasan Koçi e Ramadan Kanxha. Ky krah, me 26 shtator 1913, çliroi Strugën dhe vazhdoi sulmin e mëtejshëm. Më 27 shtator 1913 kryengritësit e këtij drejtimi kishin kapur pozicione strategjike në Malet e Petrinos që dominojnë mbi Resne. Po këtë ditë ushtritë serbe detyrohen të tërhiqen tek Resnes. Në këto luftime ku ushtria serbe la 1000 të vrarë e 300 ushtarë të kapur rob, [10] ra dhe Hoxhë Buci me të birin, Mustafajn. [11]

Gjaku i Hoxhë Bucit, i të birit, Mustafait dhe i dibranëve të tjerë u derdh në malet e Petrinës, Jamës dhe Vllanicës, duhet t'i kujtojë diplomacisë evropiane se vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, 1913 duhen hedhur poshtë. Janë eshtrat e Bajram Bucit në malet e Petrinos, në këtë vis të Shqipërisë Lindore, që dëshmojnë e i apelojnë Europës së sotme demokratike të korrigjojë gabimet e 95 vjetëve më parë.

Hoxhë Buci është dekoruar me medaljen "Për veprimtari patriotike". Një vlerësim do të ishte në nderin e institucioneve tona demokratike në këtë 95 vjetorin e rënies së Bajram Bucit dhe djalit të tij Mustafait. Kështu u bëftë!

Referencat

1. Bajram Totraku, tregimtar gojor, vjeç 70, Peshkopi.
2. "Dibra dhe dibranët", Peshkopi, 1981, f.148.
3. Po aty, f.201.
4. Po aty, f.233.
5. "Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912", përgatitur nga Stefanaq Pollo e Selami Pulaha, Tiranë, 1978, f.47.
6. Bajram Totraku, kujtime të cituara.
7. Kristo Frashëri, "Abdyl Frashëri", Tiranë, 1984, f.298.
8. "Dibra dhe dibranët", Peshkopi, 1981, f.225.
9. Arkivi i Institutit të Historisë, fondi i Vjenës, informacion i konsullit austriak, Manastir, 11 mars 1899, nr.279.
10. Kristaq Prifti, "Lidhja e Pejës", Tiranë, 1984, f.279.
11. Masar Rizvanolli, Gjurmime albanologjike, seria e shkencave historike, Prishtinë 1991, nr.2, f.331.

Kujtesë



Në 5 vjetorin e pesënjakëve!

E shikojmë çdo mëngjez kur bashkë me pesë fëmijë të vegjël ecën e qetë para bllokut të banesave "Gintash"kur çon fëmijët në kopësht. Janë pesë djem pesënjak dhe tani edhe pak e mbushin pesë vjeç. Fëllënza Kupa i lidh fëmijët e vetë u shkon pas, pasi e ka tepër të vështirë që t'i marrë vetëm. Ajo zbriti nga Kalaja e Dodës drejt metropolit shqiptar për një jetesë më të mirë. Atëherë ishte bërë nënë dhe kishte vetëm dy fëmijë të vegjël për të rritur. Nuk e kishte imagjinuar se një mrekulli në qenjen e saj njerëzore do të ndodhte. Pikërisht në metropolin shqiptar, në maternitetin e Tiranës lindi pesë fëmijë e që të pestët ishin në peshë e djem. Asllani, Beqiri, Sabedini, Shkëlzeni, Resuli. Kjo ishte një dhuratë nga vetë Zoti për Fëllënza Kupën e cila u bë nëna e pesë djemve njëherësh. Emri i saj u lakua mjaft nga mediat të cilat e sensibilizuan mbarë opinionin shqiptar.

Mjaft individ dhe shoqata shprehën gadishmërinë për t'i ardhur në ndihmë kësaj nëne nga Kalaja e Dodës që solli në jetë pesë djem. Ajo që e mori seriozisht dhe e zgjidhi qesen për këtë familje të re ishte Xhoana Nano e cila me kontributet e saj bëri të mundur që në bllokun e banesave "Gintash" t'i dhurojë një shtëpi banimi kësaj familje tashmë të madhe. Sot fëmijët janë rritur edhe për pak kohë festojnë pesë vjetorin e lindjes. Në çdo përvjetor Xhoana Nano ka qenë e pranishme, ka gëzuar bashkë me Fëllënzën e fëmijët. Në këtë pesë vjetor që po vijnë Fëllënza nuk e di se a mund të vijë kjo grua bujare të gëzojë bashkë me të.

-Ka kohë që nuk më merr në telefon. Para pak kohësh më merrte shpesh e më pyeste për shëndetin e fëmijëve. Nejse unë i jam mirënjohëse për jetë për atë që bëri ajo grua e mirë e bujare për mua. Fëmijët tashmë po mbushin pesë vjeç.

Kur ishin të vegjël nuk kisha shumë probleme me to, tregon Fëllënza.

Atëherë më sollën dhe një edukatore në shtëpi (Fondacioni Amerikan) e cila më ndihmonte shumë në rritjen e fëmijëve . Sot vërtet fëmijët po rriten por telashet e mia po shtohen dita ditës. Edhe një fëmijë të rritësh është vështirë për kohën që po kalojmë dhe jo më pesë. Ja unë çdo ditë zbres dhe ngjitem katër herë nëpër shkallët e pallatit pasi këtu nuk ka as ashensor. Imagjino të zbresësh shkallët me pesë fëmijë njëherësh të cilët duhet t'i kontrollosh pasi kacavjeren në hekurat anësore të shkallëve. E Fëllënxa i lidh të pestë kur i çon në kopësht.

-Nuk kam rrugë tjetër pasi më ikin dhe më largohen, tregon Fëllënxa.

Ato sot janë të rritur dhe është vështirë që t'i mbash bashkë për rruge ku trafiku i makinave është mjaft i ngarkuar. E kanë parë të gjithë kalimtarët këtë nënë shembullore çfarë sakrifice bën për të rritur fëmijët. Në kopësht e kanë ndihmuar pasi nuk ka mundësi për ta përballuar pagesën për pesë fëmijë. Fëllënxa edhe sikur të gjejë punë e ka të pamundur pasi e gjithë dita e saj është tej e ngarkuar vetëm me përkujdesjen ndaj fëmijëve. Burri emigrant në Greqi e më së fundi pa punë pasi nuk ka dokumente të rregullat. Për këtë familje me shtatë fëmijë të vegjël mjaftojnë vetëm 25000 mijë lek që jepen nga buxheti i shtetit dhe asgjë më shumë.

-Shpeshherë më kanë ndihmuar biznesmenë dibranë, thotë Fëllënxa. Tashmë për një vit ushqimet m'i jep "Euromax". Po shteti pse hesht? Në minibashkinë nr 11 Laprakë ku dhe ka lejen e banimit kjo familje zbritur nga Kalaja e Dodës e kanë tepër të vështirë me i dhënë një ndihmë ekonomike ashtu siç përfitojnë mjaft familje shqiptare në nevojë. E përcjellin me buzëqeshje se do ta shikojmë me kujdes problemin tuaj. Deri tani asgjë nuk i japin e kjo thjeshtë për çështje burokratike pasi një ndihmë ekonomike i takon kësaj familje të madhe e në nevojë. Fëllënxa nuk është shumë kërkuese ndaj një të drejte që i takon sipas ligjit fundja nuk ka as kohë që të bredh dyerve të zyrave që janë zhytur në burokraci. . Për të mjafton një respekt, nja dashamirësi që kanë njerëzit qofshin biznesmenë, qofshin me pushtet për fëmijët e saj dhe vetëm kaq. Po atë që i takon si mbarë familjeve të tjera pse nuk ia japin? Eh si qenka kjo jetë. Pushtetarët as që e dinë se në Laprakë jeton një nënë, një nënë shembullore që ka sjellë në jetë pesë fëmijë njëherësh e sot që të pestët po mbushin pesë vjeç. Ndoshta do të kujtohen një ditë. Sigurisht që po kur këto fëmijë të mbushin 18 vjet e të kenë të drejtë vote. Atëherë do të trokasin dhe në dyert e kësaj nëne shembullore. E Fëllënza Kupa sot nuk kërkon mëshirë, nuk kërkon lëmoshë. Fëmijët po i rrit si rrallë grua tjetër. Po bën një sakrificë që ndoshta dhe shumë të tjera nuk do të kishin mundësi që ta bënin. Sot ajo kërkon vetëm atë që i jep ligji, të cilën nuk po ia japin.

SH. SKARRA

botime

"Barnes & Noble", *supermarketi më i madh në SHBA, për tregtimin e librave, edhe me një autore shqiptare. Dibrania* **Iva Çipuri** *sjell sukses me librin "TRANSFORM"*

"Transform", libri që mbane erë Shqipëri


Nga: **BEQIR SINA, Nju Jork**

PHILADEPHIA - PENNSYLVANIA: Libri "*Transform*", është një nga librat e vetëm që ka hyrë deri më tani në njërën prej librarive më pretigjoze në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Libri i botuar dhe promovuar vitin e kaluar mund të gjendet në të gjitha libraritë e *"Barnes & Noble"*, supermarketi më i madh në SHBA, për tregtimin e librave. "*Barnes & Noble*", ka libra të autorëve më të famshmit në botë. "*Barnes & Noble*", jo vetëm tregton, por edhe furnizon me libra bibliotekat publike e institucionet shkollore të SHBA-së. "*Barnes & Noble*", është qendër e blerjes dhe shitjes, ndërhuazimit dhe katalogimit për literaturën në gjuhë të huaja, më e madhja në botë. Autorja e librit, një dibrane e emigruar në SHBA, Iva Çipuri, i tha gazetës sonë se: "Kam 10 vjet që jetoj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Së fundi, kam botuar një libër të ri në gjuhën angleze, bazuar në një përrallë shqiptare. Libri titullohet "*Transform*" që në shqip përkthehet "*Transformo*" ose "*Transformohu*". Ky libër, që tashmë mund të gjendet në të gjitha libraritë e "*Barnes & Noble*", tha ajo, është në zhandërrin e fantazisë, dhe bën fjalë për dashurinë e dy të rinjëve që ndeshen edhe me konflikte me personazhet që mëshirojnë të keqen. Gjatë rrugës së përshkruar në libër këto personazhe transformohen në qëneje të ndryshme, të cilat në lidhje me transformimet kane një kuptim simbolik. Dhe gjithashtu ata shkaktojnë transformimin e vetë personazhit negativ, që është dragoi i madh, ose siç e njohim ne në gjuhën popullore, "Kuçedra".

Në rast se lexuesi ka interes (meqënëse libri i shkruar bazohet në një përrallë shqiptare), mund të shohë edhe një artikull të botuar në një gazete lokale: University City Revië, në Filadelfia për librin *Transform*. Libri është në gjuhën angleze me titullin *Transform!* dhe nëntitull *Based on an Albanian Fairy Tale*. Është gjithashtu edhe në dy faqet elektronike të shitjes dhe blerjes së librave www.amazon.com dhe www.barnes&noble.com

Autorja e librit Iva Çipuri, tha për gazetën "Rruga e Arbërit", se libri deri më tani është pritur mjaft mirë në qarqe të ndryshme të letërsisë, e tek lexuesi në SHBA, sidomos ai është vlerësuar nga shqiptaro-amerikanët.

Gjate një aktiviteti që është zhvilluar në Filadelfia për promovimin e librave të autorëve shqiptarë, që



jetojnë e punojnë në këtë qytet, kryetari i shoqates "Bijtë e Shqipes", zoti Llazar Vero, ka folur ndër të tjera edhe për librin e autores Iva Cipuri *"Transform"*. Ai ka thënë se: "Ky nuk është libri i parë i kësaj autoreje botuar në anglisht. Libri i saj i parë është vellimi poetik "*Lightfoam*" i botuar në Tiranë më 1998. Në Amerikë, më 2005, ajo botoi në revistën për letërsinë e fëmijëve *"Up the Beanstalk"*, poemen "*Water is an animal*". Në fund të vitit që shkoi ajo botoi librin "*Transform*", mbështetur mbi një përrallë shqiptare.

Libri është pritur mirë nga media dhe lexuesit, që në hapat e para të tij. E veçanta e kësaj autoreje qëndron në faktin se ajo ka vendosur të botojë kryesisht në anglisht dhe libri i fundit, flet për një nismë tjetër të bukur të saj, të shfrytëzojë me fantazi e frymë krijuese folklorin, kulturën dhe traditën shqiptare. Ne kemi shumë nevojë për këtë, tha folësi, dhe tani i kemi të gjitha mundësitë që brezi i ri i emigrantëve shqiptarë ta bëjë këtë jo vetëm në anglisht, por edhe në gjuhë të tjera të mëdha si në frengjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, etj.

Ne kemi nevojë që historinë dhe kulturën tonë ta njohë e gjithë bota, kësaj radhe të shkruar nga vetë shqiptarët dhe jo nga vetëm pak miq e dashamirës të vendit tonë e më shumë autorë dashakeqë të tij, ka pohuar kryetari i shoqates "Bijtë e Shqipes", zoti Llazar Vero . Për autoren dhe krijimtarinë e saj kane folur edhe lexues të tjere, poetë, shkrimtarë e kritikë.

TRANSFORM

Libri i saj i sapobotuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është në



IVA CIPURI

Iva Çipuri, thonë ata që e njohën, është si gjithë të tjerët nga Shqipëria. E lindur në Peshkopi, atje kreu dhe studimet e para. Në vitin 1996 ajo mbaron Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, për gjuhën angleze në Universitetin e Tiranës. Për rezultate të larta në përfundimin e Universitetit, emërohet po aty dhe fillon të japë mësim për gjuhën angleze. Mbas një viti, në vitin 1997, Iva largohet për në Greqi ku punon në Ambasadën Amerikane në Athinë. Paralelisht jep edhe mësim në anglisht në shkollat greke.

Në vitin 1998 boton në Tiranë, librin e saj të parë "*Lightfoam*", (Shkume drite), një përmbledhje poezish në gjuhën angleze. Në vitin 2000, Iva shkon në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në vitin 2005 del botimi i saj i dyte dhe i pari në Amerike me poezine "*Water is an Animal*" (Uji është kafshë),që u botua në revistën e letërsisë për fëmijë *"Up the Beanstalk"*.

Iva ka bërë edhe mjaft përkthime / shqipërime. Disa prej tyre janë botuar në revistën kulturore shqiptare *Mehr Licht* në Tiranë, si p.sh.: poezi nga katër poetë suedeze (Edith Sodergran, Par Lagerkvist, Gunnar Ekelof, Harry Martinson), botuar në numrin 3 të revistes së sipërpërmendur në maj 1997 dhe "Shtëpia e magjepsur", nje tregim nga shkrimtarja e shquar angleze, Virginia Woolf, botuar në numrin 5 të së njëjtës revistë, në shkurt 1998. Iva Çipuri, së bashku me babain e saj sot punon e jeton ne qytetin e Filadelfias dhe është anëtare aktive e shoqatës "BIJTE E SHQIPES". Ajo flet në gjuhët shqip, anglisht, frengjisht dhe greqisht.

zhanrin e fantazisë dhe titullohet "Transform". Ky liber është bazuar mbi një përralle shqiptare dhe është shumë tërheqës për lexues të të gjitha moshave.

Ja me pak fjalë çfarë trajtohet në këtë libër.

Që nga faqja e pare e deri në atë të fundit, libri mban erë Shqipëri, jo vetem për faktin se është mbështetur mbi një përralle shqiptare, por edhe sepse autorja e ka patur këtë në qendër të vëmendjes së saj. Stili i saj është elegant dhe i thjeshtë njëkohësisht, interesant për lexuesit e të gjitha moshave. Autorja ka dale bukur tej kufijve të përrallës, dhe ka bërë që gjithë subjekti të tingëllojë herë-herë si një triller i ditëve tona, por i mbushur me fantazinë, alegorinë e shquar dibrane dhe bukurinë e përrallave shqiptare. Në qendër të subjektit është dashuria e dy të rinjëve si mijëra e miliona dashuri të bukura, por që u duhet të luftojnë kundër mallkimit që ka rënë mbi një popull të kthyer në dragon: *"Dragoners were normal human beings before they started to fight with the Sons of the Son..."* Dy të rinjve u duhet të kalojnë shumë rreziqe. Rruga e tyre është e mbushur plot me të papritura, pengesa, zgjuarsi dhe gabime, fantazi dhe humor, është e mbushur, natyrisht, me transformime befasuese.

Dragonieret, ishin njerëz normal përpara se të fillonin të luftonin me djemte e Diellit. "*Transform*" është një histori e pa kohë, që gëlon me dashuri dhe urrejtje, me rreziqe dhe guxim, me mençuri dhe çmenduri, me ankth dhe humor e mbi të gjitha, natyrisht me transformime. Kur vajza e guximshme e mbretit, gjithnje e etur për aventura, niset në kërkim të të dashurit të saj të ikur, jo vetëm që arrin të zbuloje sekretin e tij, por një botë e tërë e re dhe e çuditshme hapet përpara saj dhe e mbështjell të tërën. Është një botë e mbushur me prova dhe rreziqe, në një vend krijesash nën "mallkim".

"Uji është kafshë"

Uji është kafshë:
Ai zvarritet,
Fryme merr,
Mblidhet kutullaç;
Lëkurë të shumta ka:
Të kaltra,
Të gjelbra,
Të kafta.
Vrapon
Përmes luginash,
Fushash e rrëpirash,
Nëntokë të flerë shtrihet,
Pastaj pupthi hidhet,
Pengohet
E përdridhet,
Rënkon,
Si luan çirret,
Pastaj në pritë fshihet;
Si gjarpër
Kullon
Fije-fije,
Gjersa në kope të madhe mblidhet;
Një çast gjithë inat zien,
Çastin tjetër fare s'ndihet;
Si ngjalë
Të rrëshqet
Mes gishtërinjve,
Pastaj të përmbledh me
forcë goxille.
Uji është kafshë-
O ti e zbut atë,
O ai të gëlltit të tërë

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

duke u pajtuar dhe duke bashkëpunuar
gazeta hap faqet e saj për të rinjtë e shkollave, kryesisht për ata
që pretendojnë të fillojnë rrugën e gazetarisë, duke krijuar hapsira të posaçme
për krijimet e tyreletrare e publicistike...

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

www.dibra.org

Shkruaj dhe ti mendimin tënd!

Këngëtarja e mirënjohur e muzikës popullore Vera Laçi bëri promovimin e albumit të saj "Oj Xhemile"

Vera Laçi me një album të ri



Më datë 12 nëntor në një nga sallat e Akademisë së Arteve, këngëtarja e mirënjohur e muzikës popullore Vera Laçi bëri promovimin e albumit të saj "Oj Xhemile". U mblodhën të gjithë bashkë, këngëtarë e artistë, qytetarë e njerëz dashamirës të artit, biznesmen e politikanë. Ishte pikërisht këngëtarja Vera Laçi ajo që i bashkoi dibranët bashkë në një sallë dhe në qendër të metropolit shqiptar. Një promovim ky disi i veçantë për llojin e tij. Një takim mes miqsh e kolegësh, një mbrëmje e bukur, një festë mes këngëtarëve e artistëve. Gazetari i njohur sportiv Defrim Methasani kishte marrë barrën më të vështirë në këtë spektakël . Ai drejtoi me profesionalizëm këtë aktivitet kulturor. Ishin të pranishëm deputetët e Dibrës Sadri Abazi e Albert Faruku. Kishte ardhur për këtë aktivitet të veçantë nga Peshkopia edhe kryetari i bashkisë zoti Ilir Krosi, i cili u fut i pari në valle mes artistëve dibranë.

-Na zbardhët faqen edhe këtu në metropolin shqiptar tha në fjalën përshëndetëse kryetari i bashkisë. Ju keni bërë shumë për Dibrën dhe ja tani po bëni dhe për vendin. Në këtë promovim ishin dhe poetët Agim Doçi e Naim Plaku, biznesmeni Rakip Suli, këngëtarët Denis Delia, Hajredin Gjeta, Aranit Hoxha, Valbona Mema, Vitore Matoshi, Lirie Rasha, Ingrid Jushi, Qerim Sula e Sherif Dervishi.

Deputeti Sadri Abazi në fjalën e tij tha:

-Sa mirë për artistët e Dibrës që vlerat e tyre po i demonstrojnë edhe këtu në Tiranë. Jo vetëm kaq por edhe në skenat e botës dibranët kanë treguar se në Dibër ka vlera të mëdha kulturore. Edhe deputeti Albert Faruku përgëzoi këngëtaren Vera Laçi bashkë me kompozitorin e mirënjohur Edmond Zhulali-Mondi ka marrë pak nga Gjirokastra, tha Albert Faruku, pasi këtë muzikë të bukur ka ditur se kujt duhet me ia dhënë.

-Kjo sallë është e vogël për artistët dhe këngëtarët dibranë, tha në fjalën e tij biznesmeni Rakip Suli. Dibranët e kanë treguar herët se kanë vlera dhe këto vlera të bukura që mbartin duhet që t'i demonstrojnë në jë sallë tjetër. Pse jo dhe në Pallatin e Kongreseve.

Ky promovim sado që Defrim Methasani u mundua që t'i jap ngjyrat e seriozitetit doli edhe nga kornizat dhe çdo gjë u improvizua në çast në ato mjedise tepër festive dhe më shumë se familjare. Bashkë me Verën dilnin edhe Liri Rasha me vajzën e saj Ingridin, Kujtim Shehu e Hajredin Gjeta, Denis Delia e Aranit Hoxha, Vitore Matoshi e Rita Lati, Valbona Mema e Qerim Sula, Sherifi e vetë Mondi. Kënga nisej nga Vera e nuk dihej se kush e përfundonte.

-Të lumtë Vera, na kënaqe të gjithëve. Dua dhe unë të isha pak si ti por nuk mundem ,tha këngëtarja Valbona Mema. Sado që e këndoj këngën popullore por ja që nuk mundem që të këndoj si ti. Me ty vetëm bilbili mund të krahasohet. Kjo natë e bukur në Akademinë e Arteve ishte e dibranëve. Ndarja ishte me një urim për Verën dhe takime të tjera më të mëdha në metropolin shqiptar. Nga vetë këngëtarja Vera Laçi të pranishmit morën albumin në disk dhuratë.

Sh. Skarra

Festa e Pavarësisë

Dibër, spektakël festiv për Ditën e Flamurit



Në sallën e koncerteve të mbushur përplot në Qendrës kulturore në Dibër të Madhe, më datë 27 nëntor 2008, u mbajt një manifestim spektakël me tinguj e ritme shqiptare, kushtuar Ditës së Flamurit organizuar nga Unioni Artistik i Kombit Shqiptar në bashkëpunim me komunën Dibra e Madhe. Në këtë manifestim merrnin pjesë përfaqësues të pushtetit vendor mes tyre edhe Azgan Aklaj, deputet nga Tirana dhe president i Unionit Artistik të Kombit Shqiptar dhe Agron Buxhaku, funksionar i BDI.

Siç u tha këtu spektakle të këtilla organizohen në kuadër të 100-Vjetorit të Kongresit të Manastirit, 96 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, 76 vjetorit të vrasjes së patriotit Hasan Prishtina, 5 vjetorit të lumturimit të Nënë Terezës, në vitin e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës,me rastin e Implementimit të Marrëveshjes së Ohrit, njohjen nga Maqedonia të Pavarësisë së Kosovës, Aprovimit nga Parlamenti i Evropian i Rezolutës për Çamërinë, Futja e Shqipërisë në NATO etj. Në këto spektakle marrin pjesë këngëtarë e ansamble më të shquara të kombit shqiptar nga Tirana, Shkupi, Tetova, Dibra, Mali i Zi, Kosova e deri te Çamëria e diaspora.

Argëtim Fida, kryetar i komunës duke përshëndetur të pranishmit theksoi, "Urime Dita e Flamurit, urime 100- Vjetori i alfabetit, urime për tërë përvjetorët e lavdishëm, urime mysafirëve, artistëve, artdashësve nga tërë trojet etnike që sonte në Dibër të Madhe që sonte nëpërmjet artit, këngës e valles, madhërojnë festën tonë më të madhe kombëtare me moton "Një komb, një histori". Shqiptarët ndër shekuj identifikuan veten nëpërmjet flamurit që nga Piroja e Skenderbeu, Lidhja e Prizrenit, Alfabeti, Kongresi i Manastirit, Kongresi i Dibrës dhe Vlora e 1912, kur u shpall Mëvetësia e Shqipërisë. Edhe pse sot fatkeqësisht ekziston një ndarje administrative e kombit tonë në pesë shtete, po përjetojmë një periudhë të bashkimit shpirtëror. Sot festojmë ditën e flamurit me dy shtete të pavarura dhe gradualisht po korrigjohet gabimi i Kongresit të Berlinit, Konferenca e Londrës dhe e Parisit dhe apetitet grabitqare të fqinjëve në të kaluarën. Flamuri kombëtar ka bashkuar gjithnjë zemrat e shqiptarëve.

Në koncertin që zgjati tri orë para publikut u paraqitën këngëtarët Arif Vladi, raposodët dibranë Ibrahim dhe Elmaz Lala, Selim Beqiri dhe Nehat Kupa, pastaj këngëtarët Nazif Çelaj, Elizabeta Marku, Bashkim Sinani, Tahir Sinani, Shaban dhe Fluida Zeneli, Nurie Miftari, Flora Teturi, Evajete Fazliu, Xheladin Miftari, Tefik Osmani, Pajazit Murtishi dhe Fetije Beqiri me monologët kushtuar lirisë, Ansambli këngë e valle nga Tirana dhe SHKA Haki Stërmilli nga Dibra e Madhe .

Rexhep TORTE

PAJTOHUNI NË GAZETËN "RRUGA E ARBËRIT"

Pajtimet në Tiranë mund t'i bëni pranë redaksisë së gazetës në numrat:
Cel: 068 31 19 232 ose në numrin fiks (04) 22 33 283.
Pajtimet në Peshkopi mund t'i bëni pranë librarisë "Fleta XXI", pranë Gjimnazit "Said Najdeni",
me nr. tel: 0218 2 4233.
Të interesuarit për abonime duhet të lënë patjetër emrin e saktë dhe adresën ku presin t'ju shkojë gazeta.

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
www.**dibra**.org

Grafika: ***Studio "m&b"****. Tel: (04)* ***2233 283****.*